

# HEJZA



## Agron Shala

*Realiteti i hidhur më ka bërë që mos ta ndjek ëndrrën që kisha si fëmijë,  
që të bëhem jurist. Pse? Sepse, siç më ka thënë nëna,  
në realitetin e tillë si avokat duhet ta mbrosh të keqen e nëse bëhesh gjykatës ta dënosh të mirën*

Nën thjerrëz

# KRIJIMTARIA NUK I PËRKET KULTURËS BUJQËSORE

**Ministritë e kulturës në botën e civilizuar përkujdesen ekskluzivisht për trashëgiminë kulturore dhe për monumentet historike si dhe për politika të larta kulturore, duke u angazhuar që diversitetet kulturore, vlerat e përbotshme, t'i paraqesin ekskluzivisht si vlerë e mbarë njerëzimit dhe jo "aset partiak"**

**Nga Avni HALIMI**

Fatkeqësisht, Republika e Maqedoni së Veriore është modeli më i keq i zhvillimit kulturor si dhe i qasjes së shtetit ndaj krijimtarisë dhe, përgjithësisht, kulturës. Në këtë shtet Ministria e Kulturës konceptohet si krye-institucion nacional kulturor, ndërkohë që është vetëm se një organ politik i ekzekutivit që përkujdeset për politikën kulturore të parapara në platformën dhe programin e partisë që drejton me qeverinë. Duke pranuar që të partizohen, me shpresë se do të hanë copën më të madhe të kekut, institucionet nacionale kulturore, asociacionet, shoqatat, komuniteti i krijuesve, artistëve etj. sikur e ndjellin këtë Ministri që të ketë pushtet absolut në zhvillimet dhe ngjarjet kulturore, duke bërë që ajo të ndjehet fuqishëm përtej të qenët organ politik, si timon i kulturës së një vendi, të një shteti, të një shoqërie. Ministria e Kulturës ka një administratë tërësisht partiake (militantë të njëjës a tjetres parti) dhe që nuk kanë lidhje me kulturë, me ndonjë profesion të krijimtarisë, të artit.

Paradoks që shkon deri në pikën më kritike të injorancës është edhe angazhimi i këtij dikasteri qeveritar që ta lozë "transparencën"! Le ta paramendojmë Ministria e sportit dhe rinisë t'i bëjë zbor të rinjtë e sportistët duke i urdhëruar që një muaj të ecin me një këmbë e muajin tjetër me këmbën tjetër, një muaj të ecin duke u zvarritur e muajin tjetër në duar me këmbë përpjetë!

A guxon që Ministria e Kulturës krijimtarinë ta llogarisë si kulturë bujqësore. Kulturat bujqësore mund edhe ta kenë ditën e caktuar kur duhet të mbillen, kur duhet të korren, sepse përtej afatit dhe kohës së caktuar, nuk mund të ketë rendimente dhe ushqim për njerëz e për gjënë e gjallë!

Ministria e Kulturës krijon komision dhe ky komision prej injorantësh për sa i përket njohurive mbi artin, vendos se cili artist, cili piktor apo skulptor mund të organizojë ekspozitë, pa e ditur paraprakisht se çfarë fondesh e vlerash artistike ka në pinakotekën e tyre shtëpiake që do të ekspozohen nëpër galeritë nacionale.

Ata që merren me libra konkurrojnë me nja 1000-1500 e më shumë tituj dhe, një komision injorantësh duhet të vendosë brenda tre muajve se cilat nga ata tituj do të përkrahen financiarisht dhe, pastaj nëse brenda 5-6 muajve nuk botohen dhe nuk dorëzohen kopjet e caktuara, skualifikohen nga "përfitimet" e kësaj Ministrie!

A ka politikë më antikulturore dhe më antikombëtare që krijimtaria letrare të varet nga një "trup" prej 3-5 anëtarëve partiakë, të cilët i marrin parasysh emrat e autorëve dhe jo dorëshkrimet e lexuara për të cilët duhet të vendosin nëse ia vlen botimi apo jo. Natyrisht, çdo anëtar i komisioneve duhet t'i hapë mirë sytë (ky është urdhër partie!) dhe mos të gabojë që të përkrahë autorë që janë të taborreve të tjera partiake. Dhe kjo, jo vetëm me direktiva partiake, por, për më keq, edhe me direktiva të vetë Ministrisë! Dhe pastaj, të thuhet se po zhvillohet kulturë institucionale?!

Kjo është vetëm "blerje e intelektualëve" dhe stimulim qeveritar për të heshtur ata që dinë të flasin e të shkruajnë! Ministritë e kulturës në botën e civilizuar përkujdesen ekskluzivisht për trashëgiminë kulturore dhe për monumentet historike si dhe për politika të larta kulturore, duke u

angazhuar që diversitetet kulturore, vlerat e përbotshme, t'i paraqesin ekskluzivisht si vlerë e mbarë njerëzimit dh jo "aset partiak"! Konkursat në Ministri duhet të jenë me afat të përhershëm. Konkursat duhet të kuptohen si mundësi e pakufizuar për të përfutur nga buxheti për aktivitet dhe zhvillim kulturor. Si në çdo sferë të krijimtarisë artistike, ashtu edhe te botimet ministria duhet të këmbëngulë për një profesionalizëm, në vlerësimet profesionale e me kompetencë! Në sferën e botimeve duhet të konkurrojnë institucionet nacionale, shtëpitë botuese, organizatat e ndryshme që merren me veprimtari botuese, shoqatat e shkrimtarëve etj. të cilët paraprakisht do të duhej të hapnin konkurse dhe të formonin komisione për vlerësimin e dorëshkrimeve të autorëve dhe, ata që kalojnë, thirren për kontratë të detajuar. Në komisione do të duhej të jenë recensentë të spikatur, kritikë letrar të mirëfilltë, emra eminentë të autorëve nacional dhe, jo të jenë me një vlerësim njëfaqëshe për fondin e titujve me të cilët do të konkurrojnë në ministri akcili institucion apo asociacion, madje të ketë vlerësim-recension për çdo titull veç e veç, si dhe mendim për titujt që nuk mund të botohen! Pra, përzgjedhës i botimeve të jenë qindra komisione të "decentralizuara" dhe jo një komision që nuk ia del t'i lexojë as titujt me të cilat konkurrohet për programin vjetor të Ministrisë.

Sa i përket programit vjetor, ç'ne që për një aktivitet të tillë të përkujdeset Ministria e Kulturës? Kjo Ministri mund ta bëjë rekapitulimin në fund të vitit të aktiviteve që i ka përkrahur dhe jo të bëjë program paraprak, sepse, në fund të vitit del që të paktën nja 10 për qind e këtij programi nuk realizohet dhe, a nuk do të duhej të llogaritet kjo pastaj si dështim i kësaj Ministrie! Nuk është në tagrin e kësaj Ministrie që të bëjë plan se sa libra do të botojë sivjet, se sa koncerte do të organizojë sivjet, se sa ekspozita do të hapë sivjet! Në tagrin e kësaj Ministrie është që të kërkojë zbatim të politikave kulturore, të kujdeset për trashëgiminë kulturore si dhe me fanatizëm të pakursyer t'i mbrojtë të drejtat e autorëve! Të ndalojë më së lidhuri "marreveshje" me shtëpitë botuese. Fare në fund, Ministria e Kulturës nuk ka arsye, as morale dhe as ligjore që, honorarin e autorit, të recensentit, të lektorit, të dizajnerit, t'i lëshojë të gjitha në xhirlogarinë e botuesve, të institucioneve nacionale e të asociacioneve letrare! Ministria e Kulturës "Cezarit duhet t'ia japë atë që i takon Cezarit dhe Zotit (krijuesve) duhet t'ia japë atë që i takon Zotit"! Secili subjekt që konkurron për të botuar, e ka të drejtën të shtrojë kërkesë për financim te Ministria vetëm atëherë kur ta ketë gati programin e vet vjetor. Pra, subjektet konkurrojnë me programe vjetore dhe nuk harton paraprakisht program vjetor Ministria për Kulturë. Është identike sikur Ministria e Ekonomisë të botojë programin vjetor për çdo familje se sa të hajë, çka të hajë, sa të blejë dhe çka të blejë gjatë një viti!

Ministria e Kulturës ekziston për artistë, për aktorë, për krijues, për shkrimtarë dhe jo për tregtarë e për xhambazë partiakë. Komuniteti i artistëve dhe krijuesve është kontribuesi i vetëm i asaj që në të ardhmen, përmes kryeveprave të tyre, trashëgimia kulturore të jetë sa më e pasur. Komisionet partiake janë "ndërtues" që ngrenë kulla prej letre mbi reliket e lashta arkeologjike!





## TIRANA, ATY KU SHKRIHET E PËRTRIHET SHQIPJA

**Gjuha, pasqyrë e strukturës sociale të një vendi, është lëmi ku vërehet më mirë se kudo shtresëzimi i bashkësisë që veçon kësaj hapësira, rregulla, stile komunikimi apo forma të marrëdhënieve shoqërore**

Ledi Shamku SHKRELI

Çdo individ që kurse lind gjendet në mënyrë të pavullnetshme, pra pa e zgjedhur ai vetë, në një të një kulture e të një gjuhe të caktuar. Pikërisht kjo gjuhë, apo kjo mater-gjuhë, e lejon atë të formësojë mendimet e veta, të kuptojë e të kuptohet brenda një bashkësie njerëzish. Këta njerëz, në fakt përdorues të së njëjtës idiomë, formojnë kësaj një bashkësi të caktuar gjuhësore. Për rrjedhojë Gjuha nuk mund të mendohet pa Bashkësinë Gjuhësore që e ushtron, sikurse edhe kjo e fundit merr kuptim veç falë një gjuhe të dhënë, gjë që i jep bashkësisë qoftë formën, qoftë përmasat. Në sheshin e grupimeve gjithfarë, Bashkësia Gjuhësore rezulton më e rëndësishmja pasi ndihmon të depërtoarit në domenin e psikës dhe kulturës së masave folëse. Me fjalë të tjera Gjuha, pasqyrë e strukturës sociale të një vendi, është lëmi ku vërehet më mirë se kudo shtresëzimi i bashkësisë që veçon kësaj hapësira, rregulla, stile komunikimi apo forma të marrëdhënieve shoqërore. Lidhur me këtë Orioles thotë: "Shoqëria ndahet në grupe dhe gjuha, njëllë si ajo, ndahet në dialekte, sociolekte, regjistra dhe varietete të tjera".

Tashmë mund ta pohojmë pa droje se larushia gjuhësore me kodet që ndërrohen e kapërthehen, me strukturat gjuhësore heterogjene që japin e marrin sipas ligjësisë vetjake, me çerdhet e fjalëve ku i huaji "rosak i shëmtuar" shndërrohet në mjellmë joshëse, është diçka më se e zakonitë në cilindo vend të botës dhe nuk haset vetëm ndër repertoret e gjuhëve në kontakt. Ideja se folësi i qaset gjuhës si ndonjë mali vëngërosh, si diçkaje monolite, "masive, statike, të patundshme, të pandjeshme", ka nisur t'i lërë vend një konceptimi më real: folësi përdor shpesh mënyra të gjuhësore të çdo idiomë që njihet e që shfaqet më e thjeshtë për t'u zgjedhur. Dhe nëse marrëdhënien folës-gjuhë e mendojmë kështu, afërmendsh duhet të ndryshojmë edhe mendimin tonë mbi gjuhën.

Kush ngulmon të mbësë rob i një konceptimi të shtangët mbi gjuhën, duhet të pranojë çka thotë Jakobsoni: "cilido folës i realizon përdorimet vetjake gjuhësore përmes një përktimi Normë-Usus", por m'atë tjetër s'ka si të mos shohë shumëllojshmërinë e përdorimeve gjuhësore brenda shtatit standard. Teorikisht të gjitha përdorimet gjuhësore të lartpërmendura priren të konvergojnë drejt dy fokuseve, që (prapë teorikisht) gjenden fare pranë njëri-tjetrit Norma standarde dhe Tradita gjuhësore. Tash le t'i kthejmë sytë nga harta sociolinguistike e Tiranës, metropolit të vetëm autentik të Shqipërisë. Si paraqitet bashkësia sociale e kësaj kryeqendre në raport me qendrat e tjera urbane? Pa ngurrar asfale mund të themi: më e plota. Të shkolluar, gjysmë të shkolluar, analfabetë, zyrtarë, drejtues, gazetarë, artistë, punëtorë krahu, të papunë, studentë, shtëpiake, politikanë... lista mund të zgjatet prapë. Po përkatësia gjeografike e kësaj bashkësie? Mjafton t'i biesh kryq e tërthor Tiranës, nga qendra drejt rrethinave të saj dhe mund të hasësh gjithë krahinat e Shqipërisë. Jo rrallë qëllon që nëpër labirintet mesilloqeve të banimit është timat muzikore janë tinguj ku përzihen ritmi i çiftelisë me isopolifoninë e zgjatuar, duke marrë në rëshandë edhe ca hip-hopë të hutuara.

Sipas parimeve të alkimit, guri i çuditshëm filozofal ngërthen në vetvete zana- fillën e të gjitha lëndëve. Ai i shpërbën ato duke mundësuar shndërrimin e çdo metali të prunjtë (të varfër) në flori. Pak rëndësi ka nëse një metal i dhënë është bakër alumini apo hekur; kontakti me këtë gur, e kthen atë në ar. Atanori i kësaj alkimit bashkëkohore është pikërisht mjedisi ku kryhet fuzioni rrethina-qendër, ndërsa si gur filozofal shërben prestigji social-kulturor i gjuhës së lëvruar. Tirana e ka këtë gur filozofal, ndonëse është ende e pavetëdijshme për të. E folmja e saj, për meritë të prestigjit social që u jep përdoruesve, vijon të mbetet sociolekti më i rrahur i shqipes. Aty derdhen pa reshtur prurje gjithfarësh: të folme krahinore, nëndialekte, sociolekte e deri idiolekte të rrethinave e zonave suburbane. Këto prurje, krejt inferiore e pa status nëse shihen veçmas, kur hyjnë në kontakt me të folmen e Metropolit, shndërrohen në prurje të çmuara, të cilat me t'u shpërbërë lënda e tyre e varfër, kthehen në rivlerësuese të një "standardi"



jo zyrtar, por tashmë përdorur nga të gjithë.

Po si pritet të jetë bashkësia gjuhësore e Metropolit? Nga më të çmuarat që mund të hasë gjuhëtarët. Pa iu kthyer edhe një herë për imtësisht përbërës sociale të bashkësisë, por gjithsesi duke e mbajtur në vëmendje, pohojmë se repertori gjuhësor i Tiranës i përmban të gjitha: dialektet, sociolektet, teknolekte, burokratishen, zhargonet, krahinorizmat, ligjërimet sektoriale; të gjitha të pranëvëna, dhe çështje më e rëndësishmja, të gjitha që priren të konvergojnë drejt prestigjit - Gjuhës së Lëvruar. Banorët e Tiranës po mbledhin kodin e tyre sociolinguistik, Shqipen Pop; ajo s'do ngatërruar me Shqipen Folk, pasi është fjala për një Sociolekt. Pikërisht kjo Shqipe Pop që formësohet nga zgjedhje gjuhësore të thjeshta, të lirshme, funksionale e me prestigj paraqitet si Substandardi i Ri i Shqipes. Mungojnë ende studimet glotologjike mbi Shqipen Pop.

Ndërmarrja e këtyre studimeve do të ketë si lëndë të parë qoftë përdorimin e folur të Shqipes Pop (regjistrit e shpënguar dhe gjysmëformal), qoftë atë të shkruar (mesazhe dhe shënime në familje, letërkëmbime, ditarë, kartolina urimi, kërkesa formale drejtuar institucioneve nga shkrues të ndryshëm, titra filmash përktyer në shqip etj). Interesim më të madh e paraqet shqyrtimi dhe përshkrimi i tipareve të saj morfologjike, sintaksore, semantike, por edhe kontekstuale. Sa u përket tipareve fonetike dhe fonologjike, ato ndryshojnë diatopikisht, duke ndjekur pakashumë hartën e varieteteve krahinore. Megjithatë duket se Shqipja Pop, e folur apo e shkruar, shpesh i largohet fonologjisë së formave të sakta që përctakon norma. Flitet e shkruhet përditë për gjuhën tonë që po hepoth nën trysinë e ardhurizimeve (forestierizimeve) perëndimore. Nuk është ky problemi më emergjent i Shqipes.

Standardi i shqipes ne fakt po konkurron me Substandardin e saj; thënë ndryshe po konkurron forma "si mendohet të jetë" me formën "si është në terren". Për sa kohë do të vijojë të shpërfilllet kjo konkurrencë, përdoruesit e shqipes do të mbeten në Situatën e Gjendjes së Përkohshme, në të cilën përdorimi gjuhësor kudo dhe kurdo ka rezultuar pragmatik, pra gjuha që është shtënë në punë ka qenë e një cilësie të dobët dhe përdoruesi nuk e ka aktivizuar ndërgjegjen e tij gjuhësore. Sikundër po vërehet, shqipfolësit kanë një Sjellje Gjuhësore Pragmatike, e cila, për nga vetë natyra nuk orvatet së tepërmi të zgjedhë lema me përdorim të atrofizuar, por priret drejt rinovimit të shenjuesit. Nuk do

harruar se në cilëndo gjuhë zgjedhjet parapëlqejnë vetu minimumin e lodhjes për maksimumin e rendimentit sasior (parimi i Ekonomisë Gjuhësore). Fatkeqësisht përdoruesit e shqipes së folur ndjekin paralelisht dy shtigje:

- I përmbahen ekonomisë së tyre gjuhësore përmes polisemisë, pra përdorimit të shumzëshëm të së njëjtës shenjë. Mjafton të përmendet këtu paradigma e fryrë e shenjuesve si: grykë, qafë, bisht etj. Psh: grykë mali, grykë topi, gryka e fytit, grykë vullkani, grykë thesi, grykë çizmeje, grykë shisheje, grykë zjarr, grykë trikoje etj, etj. Disa zëra, pra, do të përdoren në vend të tërëve, duke çuar në varfërim të komunikimit.

- Përdorin si t'u vijë mbarë çdo lloj fjale të huaj që u ofrohet më shpejt e thjesht se fjalët e fondit; psh.: lançoj (hedh, lëshoj), bekground (përvojë), inspiroj (frymëzoj) e kështu me radhë. Pikërisht te kjo sjellje duhen kërkuar shkaqet e pranisë përmblytëse të lëndës së huaj në shqip. Për sa kohë nuk do ta marrim në sy konkurrencën mes Shqipes Standarde dhe Shqipes Pop, do të vijojë të vërtetohet proverbi se kur hahen dy vetë fiton i treti. Pra prestigji gjuhësor i huaj, i cili i ka zgjidhur disi mirë ngërçet e veta, nuk ngurron ta ofrojë kontrabandë zhërvjelltesinë dhe kthjelltesinë e tij për nevojat tona kurtonjëse. U tha më lart se përdorimi gjuhësor vetjake, për hir të pasportës sociale që folësit kërkojnë të fitojnë falë gjuhës, priren të konvergojnë drejt 2 fokuseve, që (prapë teorikisht) gjenden fare pranë njëri-tjetrit: Norma standarde dhe Tradita gjuhësore. Në rastin e shqipes, a është verifikuar distanca mes këtyre dy fokuseve?

Natyrisht nuk mund të shërbejnë ligjet apo rregullat si matës të kësaj distance, por ai proces i domosdoshëm tek i cili ngulmojmë kaheer: Katalogimi i Substandardit të Shqipes, vjelja dhe skedimi i përdorimeve të lira gjuhësore, por që bazohen mbi normën në fuqi. Sillet shpesh Franca si shembull i një politike të mirë gjuhësore, ngase të rreptë, por duke folur kësaj, është dëftuar vetëm gjysma e së vërtetës. Franca është në vitet '80 hartoi një ligj të paqme për mbrojtjen e pastërtisë dhe integritetit gjuhësor të frengjishtes, por po ajo Francë bëri më parë azhornimin e standardit të saj në përputhje me zhvillimet dhe prirjet gjuhësore të kohës. Dhe jo më kot azhornimi nisi si proces me idenë e Guiraud-së, i cili më 1967 shkroi: "Duhet t'i kthejmë sytë nga sociolekti i Parisit; ai ka shumë për t'i ofruar frengjishtes standarde".

Dhe s'ka kuptim ajo që thotë dikush se

azhornimi i frengjishtes u krye pasi standardi i saj që disashekullor, e për rrjedhojë ky yni s'paskësh nevojë pasi mosha e tij s'është veçse disadekadëshe. Nuk është mosha e standardit që kërkon ose jo azhornim, por baza dhe prapavija e tij. Ai, sikur tharnë, po përballtet me substandardin. Kushtet sociale, politike, kulturore, ekonomike të Shqipërisë së viteve '70 - kohë kur u vendos standardi - ndryshojnë kryekëput me të sotmet. A nuk duhen verifikuar këto ndryshime? SI PARAQITET bashkësia sociale e Tiranës si kryeqendër në raport me qendrat e tjera urbane? Pa ngurrar asfale mund të themi: më e plota. Të shkolluar, gjysmë të shkolluar, analfabetë, zyrtarë, drejtues, gazetarë, artistë, punëtorë krahu, të papunë, studentë, shtëpiake, politikanë... Gjuha Lagjia e gjuhëtarëve të Kosovës vijon të mbetet pararojë e fortë në punë të shqipes.

Pasi nxorën dy herë rresht botimin anastatik të Fjalorit të '54, pasi botuan gjithaq si anastatikë tre fjalorët e harruar të shqipes: atë të Gazullit, të Tases e të Shoqërisë "Bashkimi", pasi hartuan ata vetë një Fjalorsh fjalësh të rralla të shqipes, së fundmi, të vëmendshëm e objektivë edhe ndaj zhvillimeve të shqipes bashkëkohëse, ata patën kurajën të dalin me një dokument të quajtur Orientime të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës për çështje të shqipes standarde ku, përpos njohjes së efekteve unifikuese të një gjuhe të përbashkët standarde, kanë shtruar jo pa qëllim një platformë të re pune. Në dokument i mëshohet faktit se "krijimi i një forme të përbashkët të gjuhës, sado e përsosur që të jetë ajo, nuk është veçse një moment në histori të një gjuhe.

Ajo shënon një kohë të ndalur në zhvillimin e gjuhës, kështu që format e saj, duke qenë të qëndrueshme, vijnë e ngurtësohen dhe e humbin zhërvjelltesinë natyrore të jetës. Gjuha e përbashkët nuk mund të qëndrojë e fiksuar po u desh që ajo të jetë vijmish e përdorshme si e tillë. Rrethanat e reja kërkojnë nga gjuhëtarët përgjigje të shpejtë përmes një politike gjuhësore, e cila do të synonte zgjerimin e aftësive komunikuese, rritjen e fleksibilitetit të normave të standardit, ngritjen e shkallës së pranueshmërisë së standardit, gjithë duke përpunuar më tej të arriturat e tri dekadave të fundit e duke mos lejuar alternativa të skajshme të varieteteve të folura. Rezultatet e kësaj politike gjuhësore do të ndikonin që të shmangen për një kohë të gjatë zhvillimet e ndara në të gjitha kodet e gjuhës.

Studiuesit e shqipes standarde do të kenë për detyrë që të përctakojnë prirjet e zhvillimit në ndërthurje të varieteteve të gjuhës së folur mbi bazën e gjuhës së shkruar unike dhe të mundësisë së saj që të përfshihen në normë ato elemente që ndihmojnë që gjuha standarde të fitojë gjithnjë në spontanitet e t'i pasurojë mundësitë e saj shprehëse". Kështu për herë të parë në këto vite shfaqet një platformë që sugjeron t'u përmbahemi prirjeve të shqipes duke përctuar më pas një politikë, e cila rrit shkallën e pranueshmërisë së standardit. Me fjalë të tjera është e udhës që gjuhëtarët të bashkërendojnë punën për të hetuar dhe orientuar proceset alkimit, me të cilat po gatitet vetu substandardi i shqipes (tashmë me risinë e një komunikimi me shtrirje të pakufizuar në gjeografinë e shqipes). Afërmendsh kjo është rruga që jep shumë më tepër rezultat në dobi të gjuhës, sesa "përkujdesja" për të vijuar mbajtjen në ngrirës të Standardit aktual nëpërmjet gjobave administrative dhe masave ndëshkimore(?).

Arsyeja është e thjeshtë: rruga që kalon përmes shkencës garanton evolucionin gjuhësor në përputhje me evolucionin shoqëror (gjuha ngërthen në vetvete evolucionin, jo revolucionin). Duhet gjuaruar pra këto zhvillime bashkëkohëse gjuhësore, që për shqipen më tepër se kudo vërehen në qendrat e mëdha urbane dhe kulmojnë natyrshëm në Tiranën-Metropol. Aty po shkrihet e përzihet thuajse gjithë ç'ofron shqipja. Hierarkia dhe dozat e kësaj alkimit gjuhësore janë në një farë mase procese vetërregulluese mbi të cilat gjuhëtarit vepron. Nuk mbetet tjetër veçse ta shfrytëzojmë këtë përftesë të alkimit metropolitane. Katalogimi i saj, pa e tjerë gjatë, është hapi i parë i sigurt.




# FANTAZMA E PARAARDHËSIT

Në letërsinë e shkruar në Kosovë, por edhe në Tiranë ndikimi i shkrimtarit Ismail Kadare u bë shkatërrues për disa autorë që u futën në këtë qorrsoqak, pa mundur të dalin prej andej as sot

Lazër STANI

1.  
Mund të thuhet me plot gojën se shkenca e Einstein-it është një shkencë e ardhur nga shkenca, një dije e ardhur nga dija. U deshën dekada të tëra që shkencëtarë të tjerë pasardhës të provonin eksperimentalisht, si dhe prej fakteve të mbledhura nëpërmjet vrojtimeve, vërtetësinë e teorisë së Einstein-it. E kështu pra, edhe Letërsia e Borges-it duket si e ardhur nga letërsia, çka në një farë mënyre e ka pohuar edhe vetë. Në librin e tij *El oro de los tigres*, Borges-i shkruan: "Sa janë ndikimet që mund të dallohen në këtë vëllim... Në vend të parë shkrimtarët që pëlqej, kam veçuar tashmë Robert Browning-un; pastaj ata që kam lexuar e rilexuar; pastaj ata që nuk i kam lexuar kurrë, por që janë brenda meje." Pavarësisht kësaj deklaratë fisnike, Borges-i nuk është as Sokrat, as Robert Browning as William Blake e as Franz Kafka. Ai është Jorge Luis Borges! Të njëjtën gjë mund ta thuash edhe për Gabriel Garcia Marquez-in. Në njërën prej intervistave të tij, ai thotë: "më ka bërë shkrimtar *Metamorfoza e Kafkës*." Pasi ka lexuar këtë libër, që ia pati dhuruar një miku i tij nga rrethet intelektuale të Bogotasë, Marquez-i kuptoi se mund të shkruhej edhe ndryshe, nga sa ishin shkruar të gjithë librat që kishte lexuar deri atëherë. Kontakti me letërsinë e Kafka-s që një shtysë aq e fuqishme për shkrimtarin e ri, sa e ndryshoi rrënjësisht jetën e tij. Efekti ishte çlirues. "Unë i thashë vetes se s'kam njohur askënd që i ka lejuar vetes të shkruajë gjëra si këto. Nëse do ta kisha ditur, do të kisha filluar të shkruaja shumë kohë më parë", do të pohonte ai. Nga shkrimet joserioze të botuar në media e nga rrëfimet që i shkruante vetëm për t'ua lexuar miqve të tij intelektualë, Marquez-i kalon shumë shpejt të letërsia e tij e madhe që njohim sot, duke filluar me romanin *Gjethurinat*, botuar në vitin 1955. Edhe Nikos Kazantzakis-i flet me krenari për paraardhësit e tij, për gurutë e tij shpirtërorë, pavarësisht se mirëbërës të tij të mëdhenj ai cilëson udhëtimet dhe ëndrrat. "Ndër njerëzit, të gjallë e të vdekur, shumë pak më ndihmuan në luftë e në përpjekjet e mia. Por nëse do kërkoja se cili prej tyre la gjurmë të thella në shpirtin tim, do të veçoja ndoshta tre-katër: Homerin, Bergson-in, Nietzsche-n e Zorba-n", ka shkruar autori. Nga këto referenca, duket sikur arrijmë në një përfundim pak a shumë të trishtuar që e zbeh dhe e çshenjtëron aktin e krijimit, që e paraqet atë si një cikël zinxhir, ku secili ndez nga një zjarr të vogël, herë të dallueshëm e herë të padukshëm në pafundësinë e ciklit që ripërsërit vetveten në një qerthull të mbyllur. Termi 'origjinalitet' në këtë rast bëhet i pakuptimtë dhe e gjithë letërsia botërore të ngjan me një kështjellë të vjetër, me shumë labirinte e kthina të panumërta, ku ndodh një trafikim i vazhdueshëm emocioneve, ndjesish, imazhesh, historish, nga një kthinë te tjetra, që në fund të fundit nuk sjell asgjë që është "herë e parë". Çështja që shtrohet këtu është shumë tronditëse: nëse vërtet janë shkruar të gjithë librat,



nëse vërtet tashmë asgjë nuk është "hera e parë", atëherë përse vazhdohet të shkruhet? Është e qartë se letërsia jonë nuk vjen nga hiçi, është e qartë se kjo letërsi ka paraardhësit e vet të ndryshëm te secili shkrimtar, herë të padukshëm e të heshtur, herë sfidues e shkatërrues. Dhe duke mos ardhur nga hiçi, është e kotë të flitet për një origjinalitet të plotë e rrënjësor në letërsi. Origjinaliteti, sikurse shkruan Ernesto Sabato, "nuk ekziston as në art dhe as në ndonjë vepër tjetër të njeriut: gjithçka ngrihet mbi diçka të mëparshme".

2.  
Çështja e origjinalitetit, çështja e identitetit të veprës letrare, ka qenë një nga çështjet që më ka shqetësuar gjithmonë, qysh në rininë time të hershme. Nga librat që lexonim në rini, me gjithë kufizimet në informacion që kishim për shkak të mbylljes e izolimit, herë pas herë më ndodhte të gjeja një shkrimtar tjetër, një shkrimtar paraardhës të libri që po lexoja. Ndikimi i Majakovskit dhe i poetëve të tjerë rusë në poezinë shqipe të viteve '60 të shekullit që shkoi, ishte aq i dukshëm, sa kjo poezi shpesh më dukej pa identitet e dalëngadalë filloi të krijohet brenda meje ndjenja e refuzimit. Fantazma e shkrimtarit paraardhës, ose e shkrimtarëve paraardhës, zuri të më shfaqej si prani e shkrimtarit paraardhës te një shkrimtar tjetër pasardhës në një interferencë, që në rastin më të mirë nuk ish as plagjiaturë, por as nuk mund të quhej origjinalitet në kuptimin tim të parë. Për shembull, kur lexoja, romanin *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, atëherë nxënës shkollë, ndjeja herë-herë praninë e Ernest Hemingway-it, sidomos të

romanit *Lamtumirë armë*, ashtu sikurse ndjeva shumë vite më vonë praninë e hermetistëve italianë, në veçanti atë të Giuseppe Ungaretti-t, në poezinë e Martin Camajt. Edhe te shkrimtarët e tjerë më të mirë e më të lexuar, origjinaliteti i tekstit më vihej vazhdimisht në dyshim, edhe pse kur e kur ishte e vështirë të gjeje shkrimtarin paraardhës, me ato mundësi të kufizuara që kisha për të lexuar. Çështja kryesore, që më mundoi për shumë kohë, ishte se a shkruhej letërsi origjinale, letërsi që shfaqej e ekzistonte si një krijesë e re, si krijesë e ardhur në këtë tokë për herë të parë. Shumë vite më vonë, duke lexuar Ernesto Sabato-n hasa në të njëjtin shqetësim e në një shpjegim pak a shumë bindës. Për Sabato-n, "origjinaliteti nuk qëndron te mungesa e paraardhësve, por në tonin e në shtytjen që shfaq kjo trashëgimi te pasardhësit". Kjo tezë me nxiti të rilexoja sërish Camajn, duke e rizbuluar poetin dhe duke e rivlerësuar pikërisht për ato cilësi që në njohjen time të parë e pata refuzuar në një farë mënyre, edhe pse vepra e tij kishte shijen e "mollës së ndalueme" për lexuesin shqiptar. Nuk ka dyshim se në poezinë e Camajt ndihet shkolla e hermetizmit italian, e në veçanti poeti i tij i dashur Ungaretti. Por, megjithatë, ai është një poet i shpëtuar. Në poezitë e tij ndihet fort edhe poeti, që Camaj nuk e kishte lexuar kurrë më parë e që ishte brenda tij, siç shprehet Borges-i. Ky poet me imazhet, arketipin, ndjeshmërinë dhe sistemin e vet konceptual, e ka shpëtuar poetin e vet konceptual, pavarësisht pranisë së paraardhësve, të cilët shkrimtarët shqiptarë nuk e kanë për zemër t'i përmendin. Nëse e shmangim

diskutimin për plagjiaturën, që është një kopjim i rëndomtë, çështja e raportit të shkrimtarëve tanë me paraardhësit është një nga çështjet më delikate jo vetëm për atë letërsi të dështuar që njihet si "e realizmit socialist", por edhe për letërsinë që është shkruar gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit e vazhdon të shkruhet sot e kësaj dite. Krijuesit që hynë në letërsi pas viteve '90, u gjendën në një situatë entuziazmi grotesk midis refuzimit të gjithçkaje që ishte shkruar në letërsinë shqipe dhe në veçanti refuzimit total të letërsisë së realizmit socialist dhe kontaktit me autorë e letërsi të mëdha të kulturave të tjera. Midis autorëve në proces gjatë këtyre viteve paraardhësit shfaqën aq fuqishëm, sa në letërsinë tonë mund të gjeje Borges në Durrës e në Prishtinë, Joseph Brodsky, Wallace Stevens e Allen Ginsberg në Tiranë e Gjirokastrë, Franz Kafka në Shkodër e Lushnjë. Hapja, kontakti me letërsitë e tjera, botimi i librave të përkthyer dhe etja e marrë për të shkruar poezi e prozë gjeniale, zbuloi brishtësinë e autorëve tanë dhe mungesën e identitetit në letërsinë e tyre. Këtu nuk kemi të bëjmë thjesht me prani të ndikimeve të paraardhësve, por me një trafikim të pastër të emocioneve, të imazheve, të arkitekturës e herë-herë edhe të strukturës së tekstit. Kjo letërsi mund të quhet fare mirë referenciale, pasi në shumicën e rasteve, poezive, romaneve apo tregimeve të botuara në këto vite mund t'ua gjejmë referencat në autorë të mëparshëm ose bashkëkohës. Në shumicën e autorëve të këtyre viteve gjen shkrimtarët më të pëlqyer prej tyre, gjen shkrimtarët e lexuar më parë po prej tyre. Ajo që nuk gjen te një pjesë e këtyre autorëve është shkrimtari i pa takuar e i pa lexuar më parë, shkrimtari që duhej të ishte brenda tyre, sikurse e cilëson këtë Borges-i.

3.  
Në shkencë, referencialiteti është një kriter i pashmangshëm, kusht sine qua non për një punim apo studim të mirëfillt shkencor. Kjo përcaktohet në metodologjinë e shkencës. Le të marrim si shembull librin *Vendi që zë Skënderbeu* në historinë e Shqipërisë, të Abaz Ermenjit. Në vetvete ky libër është shkruar bukur e lexohet me ëndje. Por ka një të metë fatale: nuk ka asnjë referencë shkencore, asnjë dokument a libër tjetër të cituar. Shkurt ky libër ka karakter propagandistik, sepse historia pa dokumente nuk është histori, por propagandë. Librit të Ermenjit nuk mund t'i referohesh në asnjë punim shkencor, pikërisht për shkak të mungesës së referencave e dokumenteve. Por ai që është kusht në shkencë, është fatal në letërsi. Nëse një libri me poezi ia gjen referencat në shumicën e poezive të tij, atëherë ai nuk është më libër poetik, po thjesht një viktimitë e referencialitetit, një viktimitë e trafikimit të emocioneve, të imazheve, të ndijimeve të tjetërkujt. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për prozën. Shembujt nga letërsia shqipe nuk janë të paktë. Në letërsinë e shkruar në Kosovë, por edhe në Tiranë ndikimi i shkrimtarit Ismail Kadare u bë shkatërrues për disa autorë që u futën në këtë qorrsoqak, pa mundur të dalin prej andej as sot. Pasardhësit shkrim-



tarë të Kadaresë mbetën përgjithësisht shkrimtarë të dështuar, proza e të cilëve në asnjë rast nuk u ngjiti në nivelin e prozës së Kadaresë. Edhe shkrimtarë të tjerë si Borges-i, Kafka, Buzzati, Sartre-i kanë krijuar pas vetes modele të dështuara, jo vetëm në letrat shqipe, po edhe në letërsinë e tjera. Është kjo arsyeja që e bën shumë të ndërlikuar raportin e shkrimtarit me shkrimtarët paraardhës, me shkrimtarët e pëlqyer ose të lexuar e të rilexuar, raport që herë-herë është armiqësor, idhnak, aq sa pasardhësi kërkon të mos ia zërë emrin në gojë paraardhësit, kërkon ta asgjësojë, jo thjesht te publiku, por së pari e kryesisht të vetvetja. Duket sikur procesi i shkrimit është një dyluftim midis shkrimtarit paraardhës të pëlqyer, shkrimtarit të lexuar e rilexuar dhe shkrimtarit të patakuar e të palexuar më parë. Te shumë prej autorëve të botuar gjatë këtyre viteve, ky shkrimtar i tretë ose nuk ekziston, ose është aq i dobët dhe i trembur, sa nuk guxon të hyjë në fushëbetë të gjatë procesit krijues. Mungesa në proces e shkrimtarit "të patakuar e të palexuar" më parë, apo prania shumë e dobët e tij, vetëm me disa pëshpërime, sa për të prishur punë, u krijon hapësirë paraardhësve, aq sa teksti letrar i dalë nga ky proces krijues është një tekst referencial, pra nuk është tekst i mirëfillt letrar. Librat me tekst referencial, qoftë në poezi, qoftë në prozë, janë të pranishëm te një pjesë e mirë e autorëve tanë "të kulturuar". Kjo ka bërë që të kemi shumë autorë, shumë libra, lista të gjata me emra prozatorësh e poetësh, madje të shpallur edhe "elitë" e që në vetvete nuk janë kurrëgjë tjetër veçse elita preferenciale. Dhe natyrisht, disa poetë e prozatorë, që gjithsesi kanë sjellë një standard të ri në letrat shqipe me ngjyrimin e vet origjinal e të papërsëritshëm. Trauma e realizmit socialist është duke u tejkaluar me vështirësi, ndërkohë që liria ka mbushur tregun me shkrimtarë që nuk janë. Në këtë kaos mbretëruar, në këtë botë të zhvillimit të lartë teknologjik e të komunikimit të shpejtë, krijimi i identiteteve të ndryshme nga modelet nuk është i lehtë. Aq me tepër që edhe qenia njerëzore është një qenie komunikuese, një qenie e brishtë dhe e ndikueshme. Në përgjithësi, globalizimi i shoqërisë njerëzore dikton modën e modelet e suksesshme, jo vetëm në veshje e kuzhinë, por edhe në pikturë, letërsi, muzikë, filmografi, duke krijuar një standard të ngurtësuar për qenie standarde. Pozicioni antishkollë, antistandard, ndoshta është i vetmi pozicion real për shkrimtarin, edhe pse një pozicion i tillë rebel e kërkues, mbart me vete rrezikun e vazhdueshëm të dështimit, të asgjësimit, të mospërfilljes e përbuzjes nga bashkëkohësit, që në fund të fundit është e njëjta gjë. Në këtë pozicion është gjendur vazhdimisht Franz Kafka në të gjallë të tij, por edhe poetë e shkrimtarë të tjerë që pasvdekja i ka bërë të mëdhenj. Nga biologjia dimë se çdo qenie njerëzore është gjenetiksht e papërsëritshme, është një histori që ndodh vetëm një herë, pavarësisht se vjen prej paraardhësish të ngjashëm njerëzorë e trashëgohet te pasardhës po të ngjashëm njerëzorë. Pra, biologjikisht nuk jemi të pandotur, përderisa mbajmë në trup gjenet e paraardhësve. E megjithatë jemi origjinalë, të përveçëm, të papërsëritshëm, jemi secili nga një histori unike. E tillë është edhe letërsia, kur ajo është letërsi, i tillë është edhe shkrimtari, kur ai është shkrimtar.

## NJË EKSPOZITË PËRJASHTUESE NË TIRANË

**Në ekspozitë mungonin fotot e gjithë shkrimtarëve dhe poetëve tanë të mirënjohur nga Kosova, Maqedonia e Veriut dhe viset e tjera ku flitet, shkruhet dhe mendohet shqip**

**Agim BAJRAMI**

Para pak kohësh në faqet e disa organeve tona letrare dhe jo letrare, pati reagime të forta mbi hapjen në ambientet e Qendrës kombëtare të librit dhe leximit, të një ekspozite fotografike me foto në vite të shkrimtarëve dhe poetëve më përfaqësues. Arsyeja e këtij reagimi ishte e thjeshtë. Në ekspozitë mungonin fotot e gjithë shkrimtarëve dhe poetëve tanë të mirënjohur nga Kosova, Maqedonia e Veriut dhe viset e tjera ku flitet, shkruhet dhe mendohet shqip. Personalisht u bashkova dhe unë me këto reagime dhe i konsideroj shumë të drejta, ashtu siç nuk jam dakord me organizatorët e hapjes së kësaj ekspozite për harresën e qëllimshme. Megjithë justifikimet e organizatorëve se ajo ishte një ekspozitë personale e Roland Tashos dhe nuk mund të ndërhyhej, është e qartë se "lepuri i madh fle në ferrën e vogël". Ashtu si 30 vjet me parë, edhe në fushën e kulturës dhe letërsisë mendësitë tona vazhdojnë të evoluojnë me hapin e breshkës. Edhe pse kjo ekspozitë ngjan si një keqkuptim dhe detaj i vogël, praktika e deritashme na tregon se ne vazhdojmë akoma me logjikën e vjetër dhe të papranueshme të bunkerizimit dhe mbylljes në guaskë. Edhe pse kanë kaluar dekada të tëra dhe ujërat ideologjikë janë pastruar për Ministrinë e Kulturës dhe drejtoritë e saj përkatëse të librit, krijuesit e përtej kufirit të Shqipërisë londineze, vijojnë t'i përkasin një planeti tjetër, ose një bote "nëntë male kaptuar". Edhe pse mund të ngjajë si paradoks, faktet janë mjaft kokëforta. Në vendin tonë vazhdon të punohet me të njëjtin logjikë si në sistemin diktatorial të Hoxhës, ku shkrimtarët dhe poetët e së njëjtës gjuhë dhe gjak, emërtoheshin me

parashtesat përjashtuese: "shkrimtarët shqiptarë dhe shkrimtarët kosovarë, ose ne dhe ata".

Natyrisht gjeste dhe veprime të tilla kaq të pështira e kanë hak reagimin e shkrimtarëve dhe meritojnë të dënohen nga një opinion më i gjerë, por fatkeqësisht këtu tek ne anormaliteti konsiderohet si gjithmonë normalitet dhe e kundërta. Duke bërë një bilanc të thjeshtë të veprimtarive dhe programeve kulturore unifikuese gjatë kësaj periudhe, mund të themi pa mëdyshje se për institucionet përkatëse të vendit amë, idetë e unifikimit të kombit nëpërmjet veprimtarive kulturore dhe artistike vendosen si gjithmonë "pas liste", ose edhe kur vendosen në listë, janë kaq të zbehta sa nuk ia vlen t'i përmendësh. Përveç panairëve të përbashkëta të librit në Tiranë, ku si gjithmonë pjesën e luanit e zënë shtëpitë e preferuara të botuesve nga Shqipëria (shtëpitë botuese nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut duhet të lodhesh për t'i gjetur), asgjë tjetër nuk të kujton unifikimin, por të kundërtën e tij. U bënë kaq kohë që nuk po dëgjojmë për simpoziume, konferenca apo veprimtari të përbashkëta, që të na kujtojnë ne këtë dhe ata përtej kufirit se jemi një komb, një kulturë dhe një burim. Asgjë, asgjë përveçse heshtje. Dhe kjo, kur të të gjithë flasin kundër logjikës së dy kulturave dhe bunkerizimeve sektare. Të pretendosh se po bën politikë kulturore unifikuese dhe të mohosh kontributet e poetëve dhe shkrimtarëve penë artë, si Rexhep Qosja, Azem Shkreli, Din Mehmeti, Teki Dervishi, Ali Podrimja, Ramiz Kelmendi etj, si kontribuues dhe themeltarë në ndërtimin e godinës sonë të përbashkët letrare, vetëm e vetëm se këta janë ndodhur, jo për fajin e tyre jashtë kufijve shtetërorë të shtetit shqiptar, do të thotë të jesh kontribu-

tor i së keqes dhe t'i ngulësh dashje pa dashje thikën mbas shpine letërsisë dhe kulturës së vendit tënd, të injorosh të vërtetat dhe t'i mohosh letërsisë kombëtare gjysmën e saj më të vyer. Është afërmendsh që si në çdo fushë tjetër, edhe letërsia e një kombi nuk mund të veprojë e ndarë në parcela dhe gjymtyrë pa lidhje, por vetëm si një organizëm i plotë. Shembujt e kulturave dhe letërsive të vendeve të tjera, janë një shembull dhe një mësim i mirë për këdo që ka dëshirë për të mësuar. As më shumë dhe as më pak ndarje të tilla si me thikë, si të qëllimshme, janë jo vetëm tregues papërgjegjshmërie, por edhe i mungesës totale të frymës së atdhetarisë. Një vend i vogël si ky yni e ka nevojë jetike t'i ketë, t'i mbledhë rreth vetes personalitetet e tij krijues dhe jo t'i denigrojë me harresë. Bijë fjala, si mund të bësh një sintezë të plotë arritjeve tona poetikë, nëse i heq atyre poemën e mrekullueshme Lum Lumi të Ali Podrimës, ose poezitë e jashtëzakonshme të Azem Shkrelit, Esad Mekulit, Ramadan Musliut etj. Ose si do të ndihej fondi i romanit tonë nëse do të përjashtonim prej tij romanet "Heshtja e armëve", "Sheshi i unazës", "Koha e dhive", "Gjarpërinjtë e gjakut" etj. Do të ishte patjetër një boshllëk i frikshëm. "Lukse" të tilla përjashtuese vijjnë erë të keqe dhe kanë një strategji të menduar antikombëtare. Një fjalë e urtë thotë se jo çdo e keqe vjen për keq. Ra ky mort dhe u pamë, do të thoshte shkrimtari ynë i madh, Kadare.

U desh hapja e ekspozitës fotografike me gjysmën e shkrimtarëve të kombit, për të na kujtuar se ne tashmë jemi një dhe përjashtimet dhe harresat e vlerave kombëtare nuk mund të pranohen më si dikur, edhe pse atavizmat e se djeshmes vazhdojnë të jenë të forta ende...





Me artistin Agron Shala

# HISTORIA DUHET TË LAKOHET VETËM PARA FAKTIT

Realiteti i hidhur më ka bërë që mos ta ndjek ëndrrën që kisha si fëmijë, që të bëhem jurist. Pse? Sepse, siç më ka thënë nëna, në realitetin e tillë si avokat duhet ta mbrosh të keqen e nëse bëhesh gjykatës ta dënosh të mirën



## Bisedoi: Zyrafete SHALA

Agron Shala është autor i librave "Andrra në beze", "Korça sipas një kosovari", "Dekalogu - nga Moisiu deri te Kieślowski" dhe "1981 - vidhe këtë libër". Ka tre albume muzikore - "Zerokoha", "Dy" dhe "Sot nuk dua të vdes". Ka bërë po ashtu muzikën për mbi 50 shfaqje teatri, koreodramë, filma të animuar, dokumentarë, filma të metrazhit të shkurtë. Momentalisht është duke e finalizuar albumin konceptual "Bardhezi". Është redaktor i kulturës në portalin e njohur Telegrafi. Jeton në Prishtinë.

**HEJZA: Ditë më parë doli na shtypi dhe u përurua libri juaj i fundit "1981 - vidhe këtë libër", pse ky titull, pse 1981 dhe pse 'të vidhet'?**

A.SHALA: Me 2 prillin e vitit 1981 ndërlihet momenti më i vjetër që mbaj mend. Para meje kalonin tanket e ish-APJ-së (Armatës Popullore të Jugosllavisë). Pamje jo e mirë për një fëmijë për ta pasur si kujtim të parë të jetës. Sidoqoftë, nga ajo ditë lindi kujtesa ime. Meqë jemi produkte edhe të kujtesës, ai moment nuk mund të largohet pa pasojë. Me të lindi frika, por edhe dëshira për liri. Me të lindi edhe ballafaqimi me realitetin, sepse

në shkollë na mësonin historinë që binte ndesh me gjërat që dëgjoja në shtëpi. Si fëmijë njeriu shtron shumë pyetje, sidomos kur është mes këtyre dy të vërtetave. Por, njëra e vërtetë, ajo që dëgjoja në shtëpi, duhej të mbahej fshehtë. E, në anën tjetër, në shkollë detyroheshim ta proklamoni të vërtetën tjetër të regjimit që ishte mashtrim i madh. Na flisnin për ideologjinë e vëllazërim-bashkimit, për barazinë, mirëpo ajo barazi ishte oruelliane, sepse dikush ishte më i barabartë se ne. Nga nxënësit serbë ne fyheshim, sulmoheshim, dhe kur ne mbroheshim dhe e nxirrnim hakun, i vuanim pasojat nga menaxhmenti i shkollës. Pra, te shumica mbizotëron te frika për ta thënë të vërtetën dhe për ta mbrojtur të drejtën. Ndaj, "1981"-shi në titull ndërlihet me kujtimin tim dhe me dëshirën për ta njohur realitetin. Tash së voni e pash filmin "Argjentina, 1985", ku viti 1985 simbolizon instalimin e demokracisë dhe dënimin e krimeve të juntes ushtarake. Por, për mua 1981 paraqet vitin kur kërkoj përgjigje. Sa i përket pjesës tjetër të titullit, ka të bëjë me faktin se nuk dëshiroja që dikush të mendoj se i gjithë libri ndërlihet me ngjarjet e demonstratave të vitit 1981. Pjesa "vidhe këtë libër" është marrë nga titulli i një libri të autorit Abbie

Hoffman, që ka thënë se ideologjia është sëmundje mendore. Hoffman ishte aktivist i lëvizjes jipi. Në vitet 1960 në ShBA dhe në Angli fillon një lëvizje e të rinjve rebelë, e hipikëve, që me rokenrol dhe mesazhe të paqes synonin ndryshimin, mbi të gjitha barazimin e individit me institucionin. Jipit ishin më radikalë, sidomos në luftën për fjalën e lirë. Të dy grupet, ndonëse jo jetëgjata, edhe sot frymojnë dhe botën e kanë bërë më të mirë. Sidoqoftë, meqë jam rritur me rokenrol, mendova se është mirë të ndërlihi diçka me rebelimin e dikurshëm amerikan. Po ashtu, edhe Hoffman që lindi më 1936, ka thënë se në aspektin psikologjik ka lindur më 1960. Ndërsa, te vepra "Vidhe këtë libër" [Steal This Book], ai thotë se nëse nuk të pëlqejnë lajmet, atëherë dil ti jashtë e bëj lajmet tua. Dhe, kjo thënie, analizuar në realitetin e sotëm, na mbanë peng edhe sot ta njohim si duhet të vërtetën. Jetojmë në epokën digjitale të kombinimeve të 1-shave dhe 0-zerove. Por, po ashtu jetojmë në epokën e mendimit binar ku gjithçka shihet bardhezi. Ky mendim ka pasojë të rënda. Peter Pomerantsev para ca ditësh, në një shkrim të tij, ka thënë se për dallim nga dëshira e hipikut John Perry Barlow (po ashtu hipiku Stewart

Brand cilësohet si ideolog i asaj që më vonë do të quhet internet), që hapësira kibernetike ta krijojë qytetërimin e mendjes, më human se qeveritë e mëparshme, ne sot gjendemi në distopinë e filmit "Blade Runner" ku ëndrrat për liri janë kthyer në vëzhgim; sikurse në atë film - ku bëhet lufta për ta bërë dallimin mes njerëzve të vërtetë dhe "replikantëve" robotë që imitojnë njerëzit - sot jemi në luftën e re për ta dalluar të vërtetën dhe gënjeshtërën, meqë realiteti po shtrembërohet. Pra, libri trajton edhe këtë aspekt, sepse shtrembërimin e realitetit nga të tjerët e kanë vuajtur shqiptarët, por shtrembërimi i tillë lë pasojë për secilin - edhe për atë që me mashtrime synon të keqen për tjetrin. Shembull për këtë është sot Ukraina dhe Rusia.

**HEJZA: Kthimi në periudhat e kaluara të historisë kombëtare është një veçori që haset shpesh në shkrimet tuaja; një qasje kjo efektive për ta shikuar të kaluarën nga një perspektivë tjetër, apo për të reflektuar përmes saj në realitetin aktual. Relacioni kompleks mes historisë dhe aktualitetit është një tipar vetëm i botës shqiptare, apo i ballkanasve në përgjithësi?**



A.SHALA: Në shoqëritë shqiptare nuk ka studime të mirëfillta sociologjike apo psikologjike apo ... nga të cilat mund të nxirren mësimet të dobishme për të sotmen. Mendoj se historia është shembull për të reflektuar. Por, mendoj se historia shqiptare është rob i ideologjisë komuniste. Njerëzit janë të prirë ta projektojnë fajin kudo tjetër, duke krijuar mite të reja, duke synuar për të filluar gjithnjë nga zeroja. Në vend se të kërkojnë zgjidhjet për të nesërmen, projektohen të vërtetat për të kaluarën. Pos kësaj, jemi të vetëdijshëm për shkrimet që marrin pëlqime në internet, që mund të quhen fantahistori. Studiuesja Cecilie Endresen ka tërhequr vërejtjen për këtë duke përmendur mitologjinë e re të "Pelazgianizmit", me ndjekësit që besojnë se shqiptarët kanë lidhje me egjiptianët e lashtësisë, pastaj me majatë e Amerikës, me hyjni dhe madje me UFO-t. Ndërsa, Robert Elsie ka thënë se shqiptarët nuk kanë traditë për ta shkruar historinë si histori neutrale dhe se gati të gjithë librat e botuar në trojet shqiptare janë veçse opinione për historinë. Në libër gjykojnë tendencat e të gjithë popujve të Ballkanit për ta retushuar të kaluarën. Miti serb për Kosovën dhe mendësia e tyre për serbët krejt dhe kudo, ka shkaktuar vuajtje të shumë popuj. Por, pa pasojë nuk kanë kaluar as serbët. Nga kjo qasje, ku historia bëhet vegël e pushtetit, besoj se shqiptarët duhet të shmangen.

**HEJZA: Pra, viti 1981 është vit i zë fill kujtesa juaj; në kapitullin e dytë na shfaqet edhe skena e parë e memorizuar ku gërshetohet dhuna (përmasa imazheve të tankeve), censura (përmasa vërejtjes 'hesht' që dikush ua drejton) dhe përpjekja për arratisje (që nënkuptohet nga fjala 'kokakola' që e thoni pa arsye). A do të mund të thuhej se në atë skenë është edhe pikënisja e zhvillimit tuaj jetësor, përcaktimi apo zgjedhja e asaj çfarë do të jeni më vonë?**

A.SHALA: Po kthehem prapë te historia. Jeni të vetëdijshëm për termin "jugonostalgjikët". Shumëkush është i prirë të besoj se Jugosllavia komuniste ishte vend i mundësive. Mendimet e tilla i kam dëgjuar nga shumëkush, sepse është tendenca që e mira personale të jetë mbi atë kolektive. Kjo është arsyeja se pse kam zbrëthyer historinë e komunizmit në përgjithësi dhe realitetin politik dhe ekonomik në Jugosllavi. Unë, nuk e di as sot se pse, para tankeve kam thënë kokakola. Në libër jam munduar të jap interpretime për këtë, por kjo fjalë ngjalli frikën e të tjerëve përreth dhe reagimin e babës tim kur ata më thoshin "shuj". Ishte realiteti diktatorial i një shteti ku pranë imazhit të forcës kërkohej bindja dhe heshtja, për çfarë censurohej edhe një reagim fëmije që duhej të arratisesh pranë babait për të kërkuar mbrojtje; ishte realiteti i shtetit të pabarazive më të mëdha në botë. Po e jap vetëm një statistikë nga shumë të tjerat për çfarë ka referenca në libër. Raporti i mirëqenies mes Kosovës dhe Sllovenisë ishte një me tetë. Dhe, nëse analizohen të dhënat për prodhimtarinë e Fabrikës së Coca-Colas në Lipjan, kjo po ashtu kuptohet meqë kjo piçe, si simbol i lirisë dhe i barazisë në Perëndim, ishte simbol i pabarazive në Kosovë. Mirëpo, pos diktaturës,

ne kemi jetuar edhe me të keqen tonë, si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri. Sepse, duke e menduar vetëm të mirën personale, atëherë kemi të bëjmë me fajin metafizik për të cilin ka shkruar filozofi Karl Jaspers: faji që të gjithë ne ndajmë kur lejojmë gjërat e këqija të ndodhin; dështimi për të ndihmuar të tjerët; marrja e veprimeve që në një farë mënyre mund t'i dëmtojnë të tjerët dhe me vazhdimin e jetës tonë të zakonshme kur ne e dimë se shumë të tjerë janë krejtësisht të mjerueshëm dhe se ndonjëherë mjerimi i tyre po mbështet jetën tonë. Ky realitet i hidhur më ka bërë që mos ta ndjek ëndrrën që kisha si fëmijë, që të bëhem jurist. Pse? Sepse, siç më ka thënë nëna, në realitetin e tillë si avokat duhet ta mbrosh të keqen e nëse bëhesh gjykatës ta dënosh të mirën. Pra, ishte sistem që i thyen ëndrrat dhe dëshirat e fëmijës. Dhe, qëllimi im është që të shmangem sot thyerja e ëndrrave të gjeneratave të reja.

**HEJZA: Në këtë libër ju keni ekspluar të kaluarën shqiptare duke prekur çështje të rëndësishme të saj, jeni endur nëpër epoka, keni dialoguar me mendje të ndritura të të gjitha fushave të dijes njerëzore, keni bërë një ndërthurje të fakteve historike, filozofike, religjioze, por edhe nga bota e filmit dhe muzikës. U jeni referuar një numri aq të madh të burimeve të informimit sa që krijohet përshtypja se këtë libër e keni shkruar gjatë tërë jetës, apo së paku që nga çasti kur ka filluar të funksionojë kujtesa juaj. Kjo begati e informacioneve ishte e domosdoshme për t'i zbrëthyer misteret e udhëkryqeve të historisë sonë, për ta zbrëthyer absurditetin e së sotmes, apo të dyja këto?**

A. SHALA: E kam thënë edhe në libër se për të dhënë një mendim kam menduar se duhet të kem referenca të vërtetuara. Qëllimi ka qenë të shmangem mendimi binar, projeksonet e historisë dhe tendenca për të filluar gjithçka nga asgjëja. Në libër përdoret strategjia e njohur si PNI-ja [pozitiv, negativ, interesant apo plus, minus, interesant], strategji kjo që, sipas përkufizimit, na ndihmon që të kemi pikëpamje më të qarta për një temë nëse merremi me shkak-pasojën dhe me ndarjen e faktit prej opinionit. Para tre vjetësh kam botuar një shkrim me këtë titull: "Trinomi që mban peng shqiptarët: Rozafa, Avni

Rrustemi dhe Esat Pasha". Miti i Rozafës, me të cilin merrem edhe në libër, perceptohet si sakrificë për ta ndërtuar të ardhmen; një kala më të fortë; një shtet më të fortë ... Rozafa perceptohet se është idealiste e shoqërisë njerëzore. Mirëpo, temë qendrore e mitit për të është tradhtia. Në anën tjetër, emri i Avni Rrustemit ndërlidhet me emrin e Esat pashë Toptanit. I pari merret si patriot i padiskutueshëm, i dyti si tradhtar i padiskutueshëm. Prapë jemi te mendimi binar. Të dy emrat përdoren sa herë që nxitet ndarja në "ne" dhe "ata"! Në libër përmendet ndarja në "ne" dhe "ata", por kjo ndarje sot bëhet përbrenda sojtit për të etiketuar dhe për të qenë mjet politik. E vërteta është se Esat pasha nuk e meriton të jetë simbol i tradhtisë e as Avni Rrustemi simbol i padiskutuar i patriotizmit. Në fund të këtij shkrimi kam thënë: Shqiptarët e shekullit XXI nuk kanë nevojë për Rozafën, Esat pashën e Avni Rrustemin. As për viktima, tradhtarë e heronj të rinj. Dhe, këtë ide jam munduar ta elaboroj në libër për, siç thatë ju, zbrëthyer misteret e udhëkryqeve të historisë ashtu edhe për ta zbrëthyer absurditetin e së sotmes. Mirëpo, qëllimi kryesor është të shikohet kah e ardhmja. Në fëmijërinë time, e nesërmja kishte rëndësi. Sot, fatkeqësisht, legjitimiteti për të ardhmen kërkohet vetëm në të kaluarën.

**HEJZA: Citat: "Derisa Evropa e tejkaloi errësirën e Mesjetës, shqiptarët nuk luftuan shumë për të dalë në dritë, pa çka që ata [njëjtë si edhe serbët] janë të prirë që lëvizjet e cubave ose hajdutëve t'i interpretojnë si "luftëra për çlirimin kombëtar". Në këtë citat të shkurtër, që e zgjodha rastësisht, vërehet qasja juaj çmitizuese ndaj të kaluarës. Mendoni që mitizimi është një nga shumë dukuritë që e kanë penguar progresin tonë?**

Pjesa për lëvizjet e cubave është marrë nga Malcolm. E tillë është tendenca e të gjithë popujve të Ballkanit. Në valën e lëvizjeve kombëtare, u projektua armiku më i madh e më i keq në histori, Perandoria Osmane. Dhe, për çdo stagnim prapë faji kërkohet te sundimi osman. Si shembull mund të përmendet fjalimi i vitit 1981, i liderit të komunistëve bullgarë, Todor Zhivkov (1911-1998), që ka thënë se kur kah fundi i shekullit XIV Bullgaria bie nën sundimin

osman, atëherë u ndal dhe u përmbys edhe rrjedha e natyrshme e zhvillimit historik. Dëshmi tjetër është, p. sh., legjenda serbe e Betejës së Kosovës, që pasqyron po të njëjtin fiksim në lidhje me trashëgiminë. E, kur është fjala për shtetin grek, atje më shumë merren me Antikitetin, me Bizantin ose me historinë moderne, jo shumë me periudhën osmane. Për studiuesin Mark Mazower kjo po ndodh jo sepse në Ballkan njerëzit janë të prirë për ta humbur veten në mjegullnajën e kohës, por për shkak se për ta të qenit evropian nuk thotë asgjë tjetër, përpos që ta mohojnë legjitimitetin e së kaluarës osmane. Mirëpo, të qenit evropian kërkon mendësi evropiane. Dhe, kjo është arsyeja që zbrëthet ndarjen Lindje-Perëndim, mitomotirin dhe mitin antemural, sidomos në raport me Perandorinë Osmane. Por, për të mos hyrë në detaje, duhet cekur se të gjithë ne jemi produkt i së kaluarës, të mirë apo të keqe, por në Ballkan në përgjithësi është prirja për ta projektuar të keqen diku tjetër dhe për ta ndërtuar të ardhmen me mendësinë e shekullit XIX. Në libër ka paralele me përvojat e shumë popujve tjerë. Bëhet edhe dallimi mes nacionalizmit dhe patriotizmit. Një rast nuk është përmendur në libër: Irlanda. Këto ditë, miku im dhe redaktori i librit, studiuesi Daut Daut, qëndron në Irlandë. E kaluara e këtij shteti ka qenë shumë e hidhur nën sundimin anglez, me zi buke apo ndalimin e përdorimit në publik të gjuhës (pak kush sot e flet irlandishten/galishten). Por, Irlanda është ndër vendet me përparimin më të madh ekonomik në Evropë. Historia duhet të lakohet vetëm para faktit. Irlandezët nuk e retushojnë të kaluarën, por merren më shumë me të ardhmen. E, modele të tilla të përparimit ka shumë në Evropë.

**HEJZA: Çfarë ju inspiroi ta shkruani këtë libër?**

A.SHALA: Meqë përmes filmit jam munduar të zbrëthet shumë gjëra që ndërlidhen edhe me shqiptarët (libri "Andrra në beze"), kam menduar ta bëj të njëjtën përmes muzikës rok, duke e ndërthurur edhe fëmijërinë time. E kam cekur në libër, periudha e pandemisë i dha kah tjetër shkrimit, për të reflektuar për më shumë gjëra. Të njëjtën kohë përkeqësohet edhe gjendja shëndetësore e nënës time. Më kujtoheshin këshillat, frika e saj për të mirën dhe mirëqenien time. Në anën tjetër, izolimi e imponoi humbjen e kohës në rrjetet sociale dhe në komunikimet virtuale. Ajo që lexoja, apo projeksonet e së vërtetës që dëgjoja edhe nga njerëzit me të cilët komunikoj, më bëri ta ndryshoj qasjen. Më duhet këtu prapë ta citoj shkrimin e fundit të Pomerantsevit: njerëzit priren t'i adoptojnë mendimet që ata mendojnë se janë të zakonshme, atë që studiuesi i internetit, Samuel Woolley, e quan "konsensus prodhimi". Falsifikimi i llogarive të mediave sociale çon jo vetëm në mashtrimin e përdoruesve individualë, por në një shoqëri që humbë kontaktin me atë që mendon në të vërtetë, e ku ajo që "mendon me të vërtetë" mund të riprogramohet. Dhe, kjo më shtyri të merrem edhe me të kaluarën, por, siç ka thënë kritiku Arsim Hamiti në një analizë të librit tim të fundit, në këtë rast e kaluara është pasqyrë e së tashmes.





**HEJZA: Emri juaj i shfaqet publikut shqiptar i lidhur me disa fusha të krijimtarisë, jeni gazetar, publicist, kompozitor, instrumentist, përkthyes, njohës i rok muzikës, njohës i filmit, teatrit, fotografisë e çka jo tjetër. Me cilën nga këto fusha identifikoheni më shumë? Cila prej tyre përfaqëson esencën e qenies tuaj?**

A. SHALA: Arti për mua ka qenë një formë arratisjeje; një formë e përbushjes. Në rrethanat e viteve 1980 dhe 1990 kur - siç kam thënë në libër - jeta e shumicës së shqiptarëve ishte si dënim me vdekje, në një lojë të pistë të ruletit rus pa ditur kurrë se kur e kujt do t'i kërcas arma në kokë dhe kush mund ta ketë fatin e "amnistisë", të mos shkrepjes së armës, arti ishte si mekanizëm mbrojtës që ndihmonte për ta krijuar një azil të qetësisë mentale. Artet janë të prira për të shtruar shumë pyetje, por përgjigjet nuk i jep artisti. Thjeshtë, nga degët e ndryshme të artit kam kërkuar gjithmonë përgjigje. Nuk e konsideroj veten ekspert, madje as njohës të mirë të gjithë asaj që u përmend në pyetje. Dhe, nuk e them këtë nga modestia, por sepse ashtu mendoj. Por, ajo që dua të them është që sot, në shekullin XXI, kur bota nuk është fshat global po një xhep global, është e lehtë për ta njohur të bukurën, apo së paku për të pasur referenca të duhura për vlerën. Në libër kam përmendur rastin polak, se si mbijetesën kombëtare e shihnin edhe përmes artit e kulturës. Dhe, ia dalin mbanë. Fatkeqësisht, sot jetojmë në një kohë ku secili shpallet kuturu piktor, fotograf, dramaturg shkrimtar, poet i madh dhe pjesë e lajmeve dhe e ndjekësve. Njerëzit janë të prirë për të besuar gjithçka. Miku im i madh, poeti Xhevdet Bajraj, për këtë realitet brengën më të madhe e kishte për gjeneratat e reja. Siç ka thënë ai, duke i lexuar dhe duke i ngrënë mbeturinat, u shndërruam në mbeturina. Sipas tij, e keqja është se fëmijët e lindur dhe të rritur në këtë kaos, po besojnë se kjo është gjendje normale, prandaj: shumica e tyre, gjatë leximit u fryjnë presjeve duke menduar se janë qerpikë të rënë, ndërsa pika hiq më pak se i vëllai binjak i mushkonjës që e mbyta pakëz më parë.


**HEJZA: Kam lexuar diku që një artist shumëdimensional është vështirë të jetë i lumtur; e vetmja mënyrë që ai të ndjehet rehat është të ushqejë gjatë gjithë kohës kërkesat e prirjeve të tij dhe të japë më të mirën nga vetja në shumë ndërmarrje... Nga kjo del që jo vetëm që nuk është aspak e lehtë, por të jesh artist multidimensional do të thotë të kesh dy alternativa, të punosh (lexo: të krijosh) në vazhdimësi, ose të bësh një jetë të trazuar. Cilën nga këto e keni zgjedhur ju?**

A. SHALA: Nuk e shoh veten si artist shumëdimensional, më shumë si adhures i artit, i së bukurës. Gazetarja Natalie Nougayrède ka thënë se lajmi i rremë është i keq, por historia e rreme është edhe më e keqe. Do të shtoja se po kaq i dëmshëm është edhe degradimi i artit dhe kulturës për një shoqëri. Libri im ka qasje eklektike, ndërthurje të artit, autobiografisë, historisë, sociologjisë, psikologjisë, filozofisë, numerologjisë, religjionit, mediave etj. Dhe, po e

përsërisë, qëllimi im ishte të ndërthuren mendimet për gjërat e dëshmuara dhe të shmanget mendimi binar për të mos besuar kuturu se diçka është krejt e bardhë apo krejt e zezë. Do ta përmendja këtu bashkëpunimin tim me një artist të madh që kemi, shumë të respektuar dhe njëkohësisht shumë të "heshtur" (shmang rrejet sociale dhe promovimin e punës), Faton Hasimja. Ai i ka bërë kopertinat e katër librave të mi. Bashkëpunimi me të është i lehtë, kërkon librin dhe një përmbledhje të shkurtër. Dhe, ai e dërgon propozimin të cilin menjëherë e pranoj. Në këtë aspekt, jam i lumtur që interesimi im për art më ka bërë ta kuptoj më mirë artin dhe vlerën që ka një artist i mirëfilltë si Faton Hasimja (që është po ashtu piktor dhe fotograf i mirë). Në kopertinën e librit "1981", në 3D ai e ka punuar një si bust (secili ka të drejtë ta shoh ndryshe), që duket se është i pagdhendur dhe që ka një vrimë në kokë. Por, ky "bust" i përpiluar nga numrat 1, 9, 8 dhe 1, e ka edhe shkronjën "ë". Përgjigja e tij ishte: e vura se është shkronjë e veçantë shqipe. Dhe, kjo e pasuronte konceptin tim për librin, sepse në çdo temë mund të ketë diçka më shumë; gjithçka mund të kalitet e të bëhet më e qartë. Dhe, nëse këtë synoj ta përçojë; nëse kam dëshirë që vlera e jo lajmi të krijojë opinion, atëherë, siç thoni ju, jeta është e trazuar dhe të ndjek puna e pandërprerë.

**HEJZA: Dhe për fund: Autorët, në përgjithësi, ngarendin që librat e tyre t'i botojnë në shtëpi të njohura botuese, pse ju keni zgjedhur të shkoni kundër rrymës, duke botuar në klubin "De Rada"?**

A. SHALA: Nuk mendoj se kam shkuar kundër rrymës. Dhe, nuk kam ide se çfarë në shoqërinë tonë do të thotë shtëpi e njohur botuese, kur shumica ankohen për shitje, për mungesë leximi, të fondeve etj. Vlera gjithmonë është dytësore, sidomos nëse diçka perceptohet si joprofitabile. Unë kam pasur fatin që për tre librat e mi të parë të kem bashkëpunim shumë të mirë me Shtëpinë Botuese "Armagedoni", që fillimisht e çmonte vlerën e librave të mi dhe pastaj kërkesat e mia për botimin. Botuesin Berat Dakaj nuk e kam dëgjuar asnjëherë të flasë diçka për aspektin material. Në anën tjetër, Klubi Letrar "De Rada" është nga më të suksesshmit në Kosovë, është shtëpi e madhe që shquhet për traditë, për shumë aktivitete të rëndësishme dhe po ashtu për punën profesionale. Unë kam pasur fatin të jem pjesë e aktiviteteve të këtij klubi, që janë shembull i punës së mirë dhe të ndershme jo vetëm për Kosovën; kam pasur fatin të krijoj miqësi të mirë e të shëndoshë me krerët e klubit që janë krijuar dhe njerëz shembullorë (Zyrafete Shala, Gazmend Bytyçi dhe Arsim Hamiti). Dhe, u ndjeva i lumtur kur kërkuam ta botojmë librin tim dhe që bënë të pamundurën që të dalë më së miri. I falënderoj për këtë. Për mua, shtëpi e njohur dhe e madhe botuese është ajo që ka zemër dhe sinqeritet, respekt për tjetrin. Prandaj, e falënderoj Klubin Letrar "De Rada", për angazhimin e pakursyer për librin tim "1981".



Fotografite: Fahredin Spahija



# UDHËTIMI I DON KISHOTIT

Ismail KADARE

1

Në një konferencë që u bë më pas e famshme, në vitin 1939 në Nju Jork, Thomas Mann-i duke folur për një grindje midis poetit të madh pers Firdusit, autorit të Libri i Mbretërve (Sha-name) dhe Shahut - punë honorarësh, pasi Shahu i kishte premtuar një sasi floriri për poemën e vet dhe pastaj ia kishte mohuar, kur kishte parë se poeti i shpërfillte paratë, - thoshte se gjërat e përmasave të tilla mund t'u bëjnë vaki vetëm poetëve të mëdhenj epikë. Ne të gjithë i dimë - e kemi mësuar që në shkollë - grindjet midis studiuesve grekë për vendlindjen e Homerit. Është i njohur diskutimi nëse qe Shekspiri vetë ai që i shkroi veprat e tij apo qe Bacon-i. Një gjë pak a shumë e ngjashme ka ndodhur në lidhje me Servantesin në një vend të Ballkanit, të cilin ndoshta nuk e njihni. Diskutohet se ku qe burgosur Servantesi, në Algjeri apo atje në Ballkan. Me sa duket, kjo puna e burgimit të shkrimtarëve vazhdon t'u ngjallë shumë kureshti popujve sot dhe mendoj se është domethënësi fakti që, edhe pas kaq shumë vitesh, në Ballkan flitet ende për burgimin e Servantesit, madje edhe pa ia ditur tamam emrin shkrimtarit. Një folklorist shqiptar, duke folur për legjenda dhe kronika të vjetra mesjetare, përshkroi në shtyp disa histori për Servantesin, që kishin kaluar nga goja më gojë duke hedhur tezën se ka mundësi që Servantesi nuk ka qenë i burgosur në Algjeri, por në një aytet midis Shqipërisë dhe Malit të Zi. Ky studiues e bazon tezën e tij në rrëfenja pleqsh, të cilët përqendrohen në faktin se robi ishte një spanjoll shumë i ditur, për të cilin u pagua një sasi shumë e madhe parash që ta lironin nga burgu. Emri i tij ka raste që del Servantes, ka raste Servet apo Sarvet. Dhe të gjitha rrëfenjat përkojnë në një pikë: që ky rob, ky i burgosur, kishte miq në Spanjë dhe ata, që nga larg, donin ta largonin me çdo kusht. Studiuesi pohon se ka fort të ngjarë që Servantesi të ketë qenë rob në Ballkan, sepse bregdeti ballkanas është shumë i thyer dhe plot me guva e shpella të përshtatshme për piratët. Sidoqoftë, edhe sikur kjo histori të mos jetë e vërtetë, është tepër emocionues për një shkrimtar fakti që pleqtë e Ballkanit të ruajnë në kujtesë fatin dhe jetën e këtij njeriu. S'duhet harruar që këta pleq mbajnë shumë drama në kujtesën e tyre dhe në kohën që lindën këto rrëfenja, Servantesi nuk ishte botuar në Ballkan. Mendoj se është domethënëse që njerëz analfabetë të mbajnë në kujtesë një shkrimtar, ndonëse ndodh fort rrallë. Njerëzimi ka një ndjeshmëri shumë të veçantë për të krijuar, për të zgjedhur se ç'njerëz do të përdorë për krijimet e tij, me çfarë njerëzish do t'i mbrujë legjendat e veta. Sado e çuditshme që të duket, lidhja midis Servantesit dhe pleqve të Ballkanit ka një logjikë të brendshme. Një logjikë e brendshme e prek këtë lidhje dhe e pohon atë.

2

Kjo, nga ana e saj, ka të bëjë me temën që do të trajtoj më tej, me faktin që udhëtimi i Don Kishotit nuk është një udhëtim hapësiror, por bën pjesë në udhëtimin e brendshëm të njerëzimit. Udhëtimi i Don Kishotit ndodh në kohën e udhëtimeve të mëdha, siç është udhëtimi më i famshëm dhe më spektakolar i historisë së njerëzimit: zbulimi i Amerikës. Nuk mund të ketë, është e pamundur që në histori të ketë një zbulim më të madh se ky. Bota, toka, globi u dyfishua. Por ka ndodhur diçka e habitshme: ky zbulim kaq i pafund nuk la asnjë gjurmë në letërsinë botërore. Domethënë, nuk i pasuroi faqet e saj. E megjithatë, udhëtimi i një marroku nga një fshat i Spanjës në një fshat tjetër të Spanjës, një udhëtim që nuk kishte pikë rëndësie për njerëzimin, që nuk i ka sjellë atij asgjë dhe që ndoshta as që ka ndodhur fare, i jep njerëzimit një nga kryeveprat më të mëdha letrare. A është kjo një kundërshti apo është në logjikën e gjërave? Unë

besoj se nuk është kundërshti. Gjithmonë kur kanë ndodhur zbulime në botë, zbulime të mëdha, është shtruar ideja se këto zbulime do ta transformonin letërsinë. Të fundit janë udhëtimet, zbulimet kozmike dhe, sidomos, fakti që njeriu ka shkelur në hënë. Për shumë njerëz, poezia po merrte fund në botë sepse hëna, një nga frymëzueset e poezisë, tashmë humbte misterin, meqë po shkelej nga njeriu. Ne e dimë se kjo nuk ndodhi. E megjithatë, me kalimin e kohës, kanë shkuar tashmë shumë vjet, udhëtimi i brendshëm i Don Kishotit i takon këtij kalendari të brendshëm. Prandaj ka ndikuar në letërsinë botërore më tepër se shpikja e lokomotivës, më tepër se zbulimet e Kristofor Kolombit, më tepër se anijet kozmike. Ndonëse, duhet thënë, se ky personazh i madh i historisë së njerëzimit nuk ka bërë shpesh inkursione të gjalla në jetën njerëzore. Jeta e këtij personazhi është e dyfishtë, në jetën e fshehtë të njerëzimit, por edhe në jetën e jashtme, në botën e jashtme të njerëzve. Më pas do të mundohem të shpjegoj se përse, duke dalë në botën e jashtme, kjo figurë është dëmtuar jashtëzakonisht.

3

Përpara kësaj, do të hap një parantezë në lidhje me përkthimin e "Don Kishotit" në një vend të Ballkanit, në vendin tim, në Shqipëri.

Është një fakt tipik që ky personazh hyn i gjallë në histori. "Don Kishoti" u përkthye në shqip nga peshkopi i Shqipërisë. Peshkopi përpjetej ta përmbyste monarkun. Për t'i dhënë guxim vetes, në fillim përktheu "Hamletin" e "Makbethin" dhe arriti vërtet ta përmbyste mbretin. Më pas, mbreti e rrëzoi përsëri peshkopin dhe u përmbys situata

dhe, ndërsa peshkopi ishte i ngjuar e tejet i trishtuar, iu vu përkthimit të "Don Kishotit". Në parathënie, me të cilën peshkopi shoqëron librin, thoshte se "Don Kishoti" do të kuptohet në Ballkan më mirë se në çdo vend tjetër. Ai gjeti një lidhje midis marrëdhënieve të Spanjës me gjerësitë amerikane dhe lidhjeve të njerëzve ballkanas me Perandorinë Otomane, vetëm se këtu fati është i përkundërt. Ndërsa Spanja pushtoi hapësirat e mëdha amerikane, popujt e Ballkanit u pushtuan nga një tjetër forcë, që vinte nga hapësirat e mëdha. Është një lloj sikur Spanja të pushtohej nga indianët e Amerikës, e megjithatë, ndodhi pak a shumë e njëjta gjë: Perandoria Otomane, që ishte jashtëzakonisht e madhe, krijoi marrëdhënie aventureske me popujt e Ballkanit. Ajo kishte qindra mijëra ushtarë të një niveli të lartë, ushtarë të bindur, porse i mungonin oficerët. Kishte nevojë për çmendurinë ballkanase. Në këtë mënyrë shpjegohet që ushtria otomane e krijoi elitën e saj ushtarake kryesisht me oficerë ballkanas, sidomos shqiptarë. Kur u shpërbë kjo perandori, të gjithë këta oficerë dhe mercenarë mbetën pa punë. Dhe këtu e gjen paralelizmin peshkopi midis këtyre njerëzve dhe Don Kishotit e Sanço Panços, që nuk kanë shkuar në Amerikë, por bredhin poshtë e përpjetë dhe fillojnë të ëndërrojnë kthimin e së kaluarës. Peshkopi shqiptar thotë se të gjitha vendet e Ballkanit në shekullin XX janë të mbushura me Don Kishotë, por ne po shohim se hiya e tij vazhdon të shfaqet edhe sot në gadishull.

4

Figura e Don Kishotit vazhdon të përdoret shumë shpesh tani midis partive politike.

Nuk ka forcë politike që të mos ketë akuzuar kundërshtarin e vet si Don Kishot. Komunistët, për shumë vjet me radhë i kanë akuzuar liderët perëndimorë si Don Kishotë. Këta të fundit kanë bërë të njëjtën gjë, duke i akuzuar stalinistët si Don Kishotë. E kështu me radhë, historia vazhdon. Ka disa javë, dëgjova në fushatën elektorale presidenciale në Francë që njëfarë Philippe de Willier, përpara kamerave, e konsideruan si një Don Kishot. Dhe, siç e shikoni, Don Kishoti del i humbur në të gjitha rastet, sepse në të gjitha rastet politikanët që ia përmendin emrin, janë në nivelin e tij dhe nuk kanë një grimë nga fisnikëria e tij.

5

Kjo është një karakteristikë mijëvjeçare e njerëzimit. Besoj se dy personazhe të letërsisë e të botës, Prometeu dhe Don Kishoti, kanë pasur një fat të përbashkët, janë korrigjuar, kanë ndryshuar, janë reformuar nga njerëzimi. Në pamje të parë, duket një nder i madh që i gjithë njerëzimi merr pjesë në ribërjen e një personazhi, porse ky ndryshim, ky korrigjim mund të jetë për mirë ose për keq. Në rastin e Prometeut, personazhi ka fituar dhe në rastin e Don Kishotit ka humbur. Por në të dyja rastet është diçka e jashtëzakonisht e veçantë që njerëzimi bëhet bashkautor me shkrimtarët. Do të mundohem ta shpjegoj këtë më thjesht. Le të marrim Prometeun: ai nuk u krijua as nga legjenda dhe as nga Eskili në kohë të tij, ashtu siç e njohim ne sot. Prometeu u pasurua nga i gjithë njerëzimi. Ai ka qenë një personazh shumë më i koklavitur se ai që njohim tani. Prometeu arriti të merrej vesh me Zeusin, ndërsa pjesa më e madhe e njerëzimit këtë fakt nuk e njehe, domethënë, nuk e rinjeh, e ka shmangur, i ka bërë një korrigjim personazhit. Me një fjalë, e ka bërë më heroik Prometeun. Me Don Kishotin, siç thamë më lart, ndodh e kundërta, i humbet fisnikëria duke e krahasuar me personazhet mediokre. Schiller-i thoshte se e imagjinonte korin e tragjediëve antike si një mur mbrojtës, si një mur që e mbron artin nga ndërhyrja e njerëzve, që nuk duhet ta prekin atë. Disa liderë komunistë, në veçanti Mao Ce Duni, u përpoqën ta shkatërronin pikërisht këtë mur nën parullën demagogjike se tek arti duhet të marrë pjesë i gjithë populli. Kjo, në të vërtetë, ishte një mënyrë për ta mbytur artin në mes të masës supermilioneshe të autorëve të gjasmuar. Natyrisht, është populli ai që e mban të gjallë artin, por tjetër gjë është ta mbash të gjallë artin dhe tjetër të ndërhysh për ta rregulluar, për ta korrigjuar, për të riformuar. Sidoqoftë, ekzistojnë personazhe të mëdha të cilat njerëzimi ka ndërhyrë për t'i ndryshuar pikërisht për hir të popullaritetit të tyre. Nga ana tjetër, ka vepra të mëdha, si "Makbethi" i Shekspirit; megjithatë, Makbethi asnjëherë nuk është kthyer në një figurë popullore në botë. Çuditërisht kjo ka ndodhur me të shoqen e tij, ledi Makbethin, e cila vitet e fundit është përdorur si figurë krahasuese për disa nga gratë e udhëheqësve komunistë, sidomos për Chiang Chingun, vejushën e Mao Ce Dunit dhe Elena Çausheuskun. Kjo tregon se mund të ketë vepra të mëdha të njerëzimit, si "Makbethi", "Fausti", "Vëllezërit Karamazov" e të tjera, personazhet e të cilave i përkasin vetëm gjithësisë së artit. Të tjera personazhe, si Prometeu apo Don Kishoti, dalin në botë dhe pikërisht për shkak të kësaj daljeje vendosen përpara një prove shumë të vështirë. Besoj se Don Kishoti vazhdon të jetë edhe sot një personazh i pashpjeguar. Është e nevojshme të bëhet një përpjekje, një përpjekje e madhe nga të gjithë, për t'i vënë nderin në vend, për ta ngritur sërish në vendin që i takon. Nuk mund të lejohet që Don Kishoti të përdoret në diskutimet politike. Historia e vërtetë e botës, ajo që i intereson letërsisë dhe së cilës i përket Don Kishoti, është historia e brendshme e saj. Kalimi nga një botë te tjetra, siç është rasti i Don Kishotit, mund të ketë rrjedhoja dramatike.





*Për frymëzimin, procesin krijues, kohën...*

# BETEJA ME KOHËN KRONOLOGJIKE

**Krijuesit i duhet komoditeti si buka. Sigurisht ky komoditet nuk nënkupton ndonjë farë luksi banal, por një hapësirë lirie për ta tejbartur veten në hemisferat e bukurisë së artit**



## Bardhyl ZAIMI

Një krijues gjithnjë është në një lloj procesi, në një lloj shqetësimi të përherëshëm për të kapur partiturat e vllimit të shpirtit të tij. Është një betejë e përherëshme pavarësisht se në çfarë rrethanash ndodhet. Realiteti dhe krijimi gjithnjë ndodhen në një betejë të përjetshme që shpeshherë prodhon krisje ontologjike, krisje në kuptimin e dyzimit, sepse edhe krijuesi si gjithë njerëzit e tjerë me njërën këmbë është në realitetin e përditshëm, ndërsa me tjetrën në ato hemisfera që thjesht janë gjendje e pastër e kulluar krijimi, që i tejkalon çdo trysni të realitetit. E thotë Eliot "koka ime nuk duron kaq shumë realitetit". Një shpirt krijues gjithnjë është një shpirt i lirë, një shpirt që synon hapësira tjera, hapësira tjera lirie, që nuk i duron ngushtitë e realitetit.

Për momentin jam në përfundim e sipër të librit të ri me tregime "Avlëmendit i pritjes". Jam pranë finalizimit, por fjala "pranë" në procesin e formësimit të një libri gjithnjë mund të duket tepër e largët, pambarimisht e pasigurt në gjithë ato trandje ontologjike që mund t'i kesh përderisa

përpiqesh të rrokësh esencat e vetes tënde, në fakt gjithë atë galeri pamjesh dhe personazhesh të pafundëm që vijnë me praninë e vetë të të thonë se "dëshirojmë të shfaqemi", mjaft qëndruam në botën abstrakte të asgjësë. Në fakt, e thotë edhe Malarre se "bota ekziston për t'u shfaqur në një libër", por ky proces i "shfaqjes" nganjëherë mbetet kaq i komplikuar dhe me kaq dilema shpeshherë asgjësuese për krijuesin. Tregimi mbetet zhanër i vështirë, por në esencë tepër joshës për t'u përhumur në ato përftesa tjetërsie që vijnë si fragmente, që vijnë si frekuenca botësh dhe jetësh të pavërejtshme, që në një farë mënyre është transkriptim i thellë i shpirtit tënd, i shpirtit njerëzor në pentagramin e pazakonshmes. Dhe gjithë kjo është një shtjellë e përshpirtshme që e kërkon lirinë krijuese, që e kërkon me çdo kusht bartjen e qenies tënde në momente ontologjike që zakonisht përshkruhet si frymëzim.

Pa diskutim, mendoj se krijuesit i duhet komoditeti si buka. Sigurisht ky komoditet nuk nënkupton ndonjë farë luksi banal, por një hapësirë lirie për ta tejbartur veten në hemisferat e bukurisë së artit ku zakonisht mund të pengojë

nganjëherë çdo gërvishtje e realitetit, sidomos bruto gjendjet që nuk përfaqësojnë asgjë. Jo detyrimisht duhet të kemi komoditet në kuptim klasik të fjalës. Më tepër këtë duhet kuptuar si ngeshmëri, apo një lloj ngadalësimi, ashtu siç e definon Kundera formësimin letrar. Urgjencat, kufijtë e mbijetesës në kuptimin social, e vrasin artin. Krijuesit i duhet ajo ngadalësi për të cilën flet Kundera për të rrokur plotninë e shfaqjeve njerëzore, për të proceduar me një lloj poetike të brendshme që shkon përtej skemave të realitetit, përtej algoritmeve të gjithëpranueshme që ravijëzojnë njëtrajtshmëri, ekzistencë uniforme njerëzore. Një krijues i çon përtej kufijve të lojërave të lirisë, duke fluturuar lart si Albatrosi i Bodlerit në qiellin e kaltër të ekzistencës së tij, ose duke zbritur poshtë në rrënojat lirike, në kalbëzimet, në harresën, në pluhurin e asaj që ishte dhe që pavërejtshëm iku, ndërkohë që duhet të rikrijohet në gjithë bukurinë e vetë, gjithnjë me grimcat më të fundit melankolisë që sillen së andejmi. Jo rastësisht Bodleri thoshte se "I vetmi ton legjitim i poezisë është melankolia".

Filozofi, Nikolaj Berdajev thotë se

krijimi ndodh në kohën ekzistenciale. Një krijues gjithnjë është në betejë me kohën kronologjike, sepse kjo kohë tërësisht kërkon ta skematizojë, ta shndërrojë në karikaturë të realitetit. Është liria krijuese ajo që e katapulton në hemisfera tjera, në dimensione tjera ku gjallojnë ndjeshmëri, personazhe, me një fjalë botë që ngulmojnë të shfaqen. Dhe përpykja për ta sjellë "një botë në një libër" gjithnjë është një oksimoron fatal, një ekzaltim, delir frymëzimesh dhe një torturë pakënaqësie dhe pasigurie vrastare. Secili krijues nga pak është Kafkë, që heziton dhe që dëshiron ta zhbëjë atë që ka krijuar.

Personalisht kam jetuar dhe vazhdoj të jetoj nën hijen vrastare të urgjencave. Mbase kjo ma ka pamundësuar t'i shkuli nga vetja ime ngeshmëri fragmentet e botëve që "kërkojnë të shfaqen". Sikurse Cioaran, gjithnjë kam besuar në fragmente. Për më tepër, duke u vënë përballë lirisë krijuese, dëshiroj ta përsëris atë që kam thënë në një intervistë për "Brezi 9": "Jam një krijues që gjallnojnë nën rrënojat e gazetarisë", ndërkohë që po përpiqem t'i jap kuptim ekzistencës sime duke shkruar.



Në shiritin e kohës

# “UJI QË RRJEDH”

(Mikpritja shqiptare e Abdurrahman Pashait nga Tetova në poemën e Ashik Kenziut)



## Metin IZETI

Abdurrahman Pashai, prefekti i Tetovës në fillim të shekullit të XIX, është një nga personalitetet më të shquara të jetës shoqërore dhe kulturore në këtë periudhë në Tetovë dhe me gjerë. Ai ishte djali i Koxha Rexhep Pashait dhe baba i shumë veprimtarëve shoqërorë dhe kombëtarë që erdhën nga loza e tij. Veçanërisht është i njohur me restaurimin e Harabati Baba Teqesë, Xhamisë së Larme në Tetovë, Çifte Hamamit në Tetovë si dhe ndërtimit të ndërtesave të verores së tij në Kalanë e Tetovës.

Në fillim të shekullit të XIX, Tetovën e ka vizituar poeti i njohur me origjinë nga Qiproja, Ashik Kenziu dhe është pritur me bujari të pasqorë nga ana e pashait tetovar. Si rrjedhojë, ai e ka shkruar edhe një poemë lëvdate për pashain të cilën e ka emërtuar, Dasitan-i med'h-i Rasim Pasha/ Poema lavdëruese për Rasim Pashain. Ashik Kenziu në poemë e ka përdorur emrin lavdërues për pashain Rasim, që e ka kuptimin metaforik “Uji që rrjedh” dhe këtë emër lavdërues Ashik Kenziu e ka përdorur për ta treguar bujarinë e Pashait dhe atë duke u bazuar në porosinë profetike, i cili vepërmirësinë e kategorizon si sinqeritet rrjedhës (sadaka xharije).

Në katërvargëshin e parë Ashik Kenziu kështu e fillon poemën e tij:

*Fisnikëria dhe pushteti të qëndroshin përgjithmonë  
Sërish e gëzove këtë zemër të dëshpëruar  
O zotni i im, o Mbret i dashur  
Të nderoftë edhe ty Zoti që gabimet mbulon*

Ashik Kenziu i mahnitur me fisnikërinë dhe burrninë e Abdurrahman Pashait i drejtohet atij me epitetet më të larta të asaj kohe, madje këtë e lidh edhe me përmasën fetare, duke iu lutur Zotit me cilësinë e Tij Settar (Mbulues i të metave), që në përshtetshmërinë islame është përdorur si lutje për mbretërit të cilët gjatë veprimtarisë së tyre shoqërore gjithsesi se do të përballen me situata kur edhe kanë mundësi të bëjnë lëshime. Në vazhdim Ashik Kenziu thotë:

*Sërish fytyra më qeshi dhe u zbukurova  
E fshiva ndryshkun e pasqyrës në shpirtin tim  
Minierë e haresë je ti, e kuptova  
Në burrnin e ke shembull Aliun trim*

Ditët që Kenziu i ka kaluar në Tetovë në konakun e Pashait si dhe në teqenë Harabati Baba, i ka karakterizuar si ditë të pastrimit të tij shpirtëror. Kjo kështu pasi ziqr dhe përmendja e Zotit, sipas porosive profetike, e lustron dhe e fshin ndryshkun e zemrës. Ndërsa fisnikëria dhe burrnia e Pashait në relacion me shoqërinë në përgjithësi është cilësuar si burrnia e Hazreti Aliut, që është sinonim i burrnisë dhe besnikërisë në përshtetshmërinë islame dhe në poezinë e tesavvufit.

*Nuk kam pa bujar si ti, o i nderuar  
Njëmijë poetë virtytet t’ua nuk mund t’i përshkruajnë  
I lutem Perëndisë që në dukje dhe fshehtësi të të ruaj  
Evliatë të jenë me ty dhe të të mbrojnë*

*Njerëzit jomirënjohës, Mbreti im, mos të të afrohen  
T’u mbyllën të dy sytë mos të të shikojnë  
Në dy botët mos të gëzohen  
Ata që bujarinë ta mohojnë.*

Në këto vargje, Ashik Kenziu, nga njëra anë lutet që Zoti dhe miqtë e Tij t’i qëndrojnë në ndihmë Pashait, ndërsa nga ana tjetër i qorton ata që nuk janë mirënjohës ndaj mirësive dhe bujarisë së Pashait. Është fakt se në këtë periudhë të trazirave shoqërore në shtetin Osman, Pashai, si edhe shumë pashallarë të tjerë të trojeve shqiptare, i kanë kundërshtuar disa nga veprimet e shtetit në relacion me trojet shqiptare dhe si pasojë e kësaj ka pasur edhe njerëz të cilët e kanë kritikuar Abdurrahman Pashain.

*Pa mungesë, Krijuesi i Madh, të ka krijuar  
Në katër anë je zgjatur, si shqiponjë fluturon  
Dielli digjet bukurinë për ta shikuar  
Hëna të sillet përreth, natën ta ndriçon.*

*Të poshtërit fisnikërinë, nuk ta kuptojnë  
Djali i vezirit nuk ka sens për bujarinë  
Prej ku ta dijë vlerën e Rasim Pashait tonë  
Një i papastër dhe cofëtinë.*

Ashik Kenziu në këtë pjesë të poemës e tregon edhe konfliktin që Pashai e ka pasur me djalin e ndonjërit prej ministrave të shtetit osman në atë kohë. Përdërisa nga njëra anë e përmend vlerën e Pashait, në anën tjetër ai e qorton dhe e tregon pakujdesinë dhe injorancën e birit të vezirit.

Në katërvargëshin e fundit Ashik Kenziu lutet për pashain duke e vendosur edhe emrin e tij poetik në varg, siç ishte traditë e të gjithë poetëve klasikë osmanë:

*Çdo shkathtësi nga Zoti ty t’u dhanë  
Gjuha e Kenziut e pamundshme të të lavdërojë  
Çdo ditë bajram dhe çdo natë, Natë Kadri, t’u bëftë  
Armiajtë u shkatëroshin, toka mos t’i durojë.*



# URA NDËRMJET LETËRSISË SË PËRSHTATJES DHE LETËRSISË SË REFUZIMIT

**Atëherë kur në një pjesë të truallit shqiptar, vetëm se ishte instaluar një dogmë e krijimit siç ishte realizmi socialist dhe tashmë letërsia ishte vënë komplet në funksion si vegël e propagimit të sistemit politik, në Kosovë po shpërthente një rryme e re jo krejt e strukturuar, por në formë të një fryme që ndjehej për një letërsi të re që do t' i kundërvihej edhe dogmës po edhe sistemit diktatorial**

Adriatik ZEQIRI

Fundi i viteve '60 dhe fillimi i viteve '70 në Letërsinë e Kosovës do të sjellë një strukturë të re si të krijimit, si të studimit dhe mendimit letrar. Tashmë është epoka e rezistencës ndaj sistemit. Ende është metafora si dominantë në diskurs. Figurimi i tekstit është i domosdoshëm e simboli bëhet qendror për të arritur në nivelet e dëshiruara të shprehjes letrare. Si pasojë do t' i hyhet në hak metonimisë dhe dalëngadalë metafora do të bëhet mbretëreshë e një diskursi etnopsikologjik ndër shqiptarët e Kosovës, duke mos arritur që të zhvendoset edhe sot nga fronti, përkundër ringritjes në disa momente të meotnimit, megjithatë kjo është për një studim antropologjik që nuk është interes i kësaj trajtese. Kjo si pasojë prodhon edhe zhanret e dyzuara. Jo pak kritik do të shohim që përmendin proza poetike (Ibrahim Rugova) ose proza lirike (Sabri Hamiti).

"Letërsia shqiptare e viteve '50-'70, për ndryshim nga të gjitha letërsitë e tjera të botës, nuk ka asnjë poet nihilist. Kjo pa mëdyshje dëshmon sa vital janë shqiptarët. Mund të konstatojmë lirisht se lufta e egër e intelektit të thellë të dekadencës evropiane kundër letërsisë shqiptare ishte e kotë." Kjo është ajo çka do të thoshte me një ironi të hollë e shumë domethënëse për atë që mendonte për epokën paraardhëse Teki Dërvishi, derisa autorë të tjerë kishin shpërthimet e tyre edhe më të hershme kundër një krijimi të mëhershëm. Atëherë kur në një pjesë të truallit shqiptar, vetëm se ishte instaluar një dogmë e krijimit siç ishte realizmi socialist dhe tashmë letërsia ishte vënë komplet në funksion si vegël e propagimit të sistemit politik, në Kosovë po shpërthente një rryme e re jo krejt e strukturuar, por në formë të një fryme që ndjehej për një letërsi të re që do t' i kundërvihej edhe dogmës po edhe sistemit diktatorial. Në fakt Fuko në një interpretim të tij thotë që sistemi i krijon edhe kundërshtarët e vet, e këtë rrjedhë edhe mjetet e nevojshme të shprehjes për ata që e kundërshtojnë atë.

Heshtja e poetit është akt terrorist, thotë poeti Dan Fante, pra poeti, shkrimtari duhet të flasë, por të flasë të vërtetën. Poeti nuk është ai i konformizmave, i himnizimeve të shtypësve, ai që pajtohet me rrjedhën e zakonshme, poeti është rebel, kundërshtues. Poezia më e fuqishme lind burgjeve, aty ku gulçon shpirti për lirinë. I burgosuri e din çmimin e lirisë më shumë se kushdo tjetër.

I tillë do të jetë edhe Teki Dërvishi, i cili e përjetoi burgun famëkeq të Goli Otokut qysh në rininë e tij të hershme. Persekutimet ndaj tij do të vazhdonin edhe më pas duke mos pasur për një kohë të gjatë mundësi që të sistemohej me punë në vendlindje dhe duke qenë gjithmonë nën vëzhgimin e pushtetit sundues Jugosllav. Kur je nën vëzhgim dhe i përcjellë edhe nga censura, kjo detyrimisht nxitë që diskursi të jetë më finok dhe më i mbuluar, komplet i koduar për të mos u zbuluar nga kundërshtari, por nevoja për të shprehur, nxjerr në pah pastaj gjenialitetin krijues. Figura latohet deri në perfeksion, shenjat janë aty për të shkuar drejt


kuptimeve tematike e ideore.

Idetë pastaj ngritën në nivele të tjera dhe krijohen lidhjet nga teksti në tekst për të krijuar librin e madh të një ideologjie antisistem. Jo më kot Teki Dërvishi në tekstet e tij do të shkruante vazhdimisht se këtë libër do ta shkruaj edhe njëherë! Kjo është thirrje për lexim, të tillë e kemi identifikuar në interpretimin që do të mundohemi të nxjerrim. Një thirrje për të parë në shtresime tjera ideo-tematike tekstet e tij. Pra diktatura ka prodhuar alegorinë. I ka dhënë poetit një armë të veçantë të shprehjes. Shprehjes së koduar, shprehjes së mbuluar, por që është aty dhe pret zbuluesin e saj të madhe.

Në këtë frymë do të krijohet poezia fillimisht për të kaluar pastaj te format e tjera letrare. Është koha e simbolizmit në letërsi, e në politikë është koha e diktaturave komuniste në lindje, pas luftë së dytë botërore por gjithashtu është koha e lëvizjeve antidiktatoriale gjithandej Evropës. Simbolizmi si rrymë padyshim do të prekë edhe letërsinë e Kosovës që po zhvillohej viteve të 70-ta e 80-ta, dhe këtë do ta shohim te shumë tekste. Megjithatë e thamë edhe njëherë që po ndërtohej dalëngadalë një libër i vetëm si rrjet i teksteve tematike për nga ideologjia e ai është libri që përmbajtje ka temën e madhe kundër diktaturës dhe shtypjes. Gjithashtu gjakimi për emancipim shoqërorë do të ishte i pashmangshëm në diskursin e letërsisë së atyre viteve kur shoqëria jonë po bënte hapa të mëdhenj drejt çlirimit nga padija dhe prapambetja. Njëkohësisht edhe shkrimtarët dhe kritika jonë tashmë kishte qasje të jashtëzakonshme në dijen botërore mbi artin dhe letërsinë dhe komunikimi i saj kishte edhe ndikimin e madh, në atë sesi shumë kritikë filluan të interpretonin veprat e ndryshme, duke ikur nga klishetë që kishte krijuar sistemi dhe duke hyrë në interpretime moderne. Refuzohej realizmi socialist si shkollë dhe leximi kishte filluar të hapej në horizonte të jashtëzakonshme ndaj disa rrymave tjera, deri te poststrukturalizmi. Teoricienë si Barti, Sosyri, Fuko, Derrida, Zhenet etj, ata ishin bërë referencë e interpretimeve, ndërsa autorë si Kamy, Kafka, Borhes, Xhojsi etj ishin modelet që reflektonin në procesin e shkrim/krijimit. Andaj, si çdo moment kthese në histori edhe ky ishte i përmasave të mëdha, duke prodhuar një nga letërsitë shqipe më të mira që kemi deri tash.

"Madje, në vijimësinë e zhvillimit të letërsisë së Kosovës, vrojtuar në planin fenomenologjik, vepra letrare e Teki Dërvishit del të jetë ura kaluese apo këputja ndërmjet asaj që e kemi cilësuar si letërsi e përshtatjes drejt letërsisë së refuzimit (së bashku me Pashkun e Musliun), sepse ndonëse botimet e saj shfaqen në vitet '70, hetohet fryma e verbit të viteve '60, e cila braktiset sidomos në fundin e viteve '70 me librin poetik-prozaik Shtëpia e sëmurë."

Kjo është edhe letërsia që lindi Teki Dërvishin, kjo është koha e tij dhe e artit të tij, artit të revoltës të dhimbjes dhe të vetnisë së madhe njerëzore. E thamë edhe në fillim sistemi i lind format nga shtypja e edhe nga nevoja për ta kundërshtuar atë. I tillë është arti i Teki Dërvishit.





# PERSONAZHI I NJË REALITETI SHUMËSHTRESOR

Në romanin e viteve të 90-ta, Kadare, na e paraqet personazhin i tij kompleks, i cili shpreh thelbin artistik, ideor, filozofik dhe kuptimor, të romanit bashkëkohor, duke depërtuar gjithnjë e më tepër në universin e brendshëm të njeriut, duke përfshirë sintetikisht e në mënyrë analitike, kohët dhe shoqërinë shqiptare në tranzicion

Mr. Lumnie Thaçi-Halili

Ismail Kadare është njëri ndër personalitetet kryesore të letërsisë së sotme shqipe, gjithashtu dhe njëri ndër personalitetet qendrore të kombit tonë. Pothuajse asnjë vepër shkrimtari a krijuesi letrar deri më sot, nuk ka përjetuar kaq shumë studime, lexime, vlerësime të ndryshme, sikurse ka vepra e këtij shkrimtari. Sepse ky shkrimtar ka një krijimtari të gjerë letrare në dhjetëra vëllime, në të gjitha fushat e krijimtarisë artistike, në romane, në tregime të shkurtra artistike, në novela, në poezi e poema, në dramaturgj, në eseistikë, në shkrime të shumta publicistike, komentuese e dokumentare, në autobiografinë komentuese etj. Janë me mijëra njësi bibliografike kritiko-letrare e studimore që e kundrojnë dhe e vlerësojnë veprën e Kadaresë nga aspekti estetik, kritiko-letrar, por edhe nga aspekti dokumentar e publicistik i pajtimeve e mospajtimeve me veprimtarinë e tij shoqërore-letrare. Por vepra e tij kundrohet edhe nga ana gjuhësore. Nuk duhet lënë anash as fjalën e drejt-përdrejtë të Kadaresë (intervistat, dialogët) që përfshihen në disa vëllime në shumë gjuhë të botës. Ai, tashmë, është një univers më vete, një univers kadarean. Vëllimet studimore, kritiko-letrare, publicistike, polemike etj., kushtuar këtij opusi të gjerë, janë botuar jo vetëm në hapësirat shqiptare, por edhe në vende të tjera të botës, si në Itali, Francë, Angli e SHBA. Është po ky univers kaq i larmishëm, i pasur, i gjerë dhe i thellë, që krijon mundësi të pakufishme vështrimi e studimi.

## Për romanin "Aksidenti"

Vepra romaneske e Ismail Kadaresë është tejet e pasur me galerinë e personazheve, e cila përbën një sfidë studimi për çdo studiues të letërsisë. Madje, studiuesi Tefik Çausi, nisur nga kjo, ka botuar një vëllim të tërë prej më shumë se 400 faqesh që iu kushtohet personazheve të Kadaresë, dhe ku përfshihen biografite artistike të rreth 1200 personazheve që popullojnë rreth 5000 faqe të prozës së Ismail Kadaresë. Aty defillojnë personazhe tragjikë, intelektualë, mësues, gra, punëtorë, princër e kontë, mbretër, si dhe personazhe të tjera nga të gjitha sferat e jetës njerëzore. Në këto romane ligjërojnë politikani, filozofi, intelektual, ashtu sikurse veprojnë, meditojnë, intrigojnë a urdhërojnë, dashurojnë, urrejnë, apo përlëshen me fatin e me të keqen shoqërore si komandantë, ushtarakë, burra shteti, udhëheqës të partive komuniste, diplomatë, ambasadorë, zyrtarë të lartë e servilë. Ky studiues, nxjerr një fakt interesant: "Jezu Krishti shfaqet në 15 vepra, Skënderbeu dhe Enver Hoxha në 9 vepra, Homeri, Shekspiri, Makbethi, Ahmet Zogu në 7, Hrushovi, Marksi, Stalini, Xhenxhis Khani në 6 vepra e kështu

me radhë." Janë mijëra personazhe që defillojnë në veprat e tij që mishërojnë vlera etike e njerëzore, shoqërore a fetare, kulturore a civilizuese, kombëtare a ndërkombëtare, politike a ushtarake, apo mercenare.


Kadare, konsiderohet ambasador i letërsisë dhe kulturës shqiptare në botë. "Është ky një shkrimtar-kolos i letërsisë së sotme shqiptare që mitet legjendare i ka kthyer në realitet. Shkrimtar që bëri histori prej prehistorisë, pa rënë në kundërtënie me vetveten dhe gjykimin modern, ai arsyetoi estetikën në mënyrë të përkorë edhe për kohën absolute" (Shaban Sinani). Ndërkaq, shkrimtari e romansieri Ismail Kadare, e ka vazhduar krijimtarinë e tij letrare, me ritme të reja krijuese edhe pas viteve '90. Romanet e tij të kësaj periudhe janë: Dosja H, Piramida, Përbindëshi, Pallat i ëndrrave, Spiritus, Qorrfermani, Breznitë e Hankonatëve, Vajza e Agamemnonit, Elegji për Kosovën, Lulet e ftohta të marsit, Unaza në kthetra, Qyteti pa reklama,

Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut, Pasardhësi, Shkaba, Hija, Muzgu i perëndive të stepës, Darka e gabuar, E penguar dhe Romanin e fundit Aksidenti. Në romanin e viteve '90, Kadare, na e paraqet personazhin i tij kompleks, të ndërlishëm, i cili shpreh thelbin artistik, ideor, filozofik dhe kuptimor, të romanit bashkëkohor, duke depërtuar gjithnjë e më tepër në universin e brendshëm të njeriut, duke përfshirë sintetikisht e në mënyrë analitike, kohët dhe shoqërinë shqiptare në tranzicion. Romanet e tij vijnë me procedime të ndryshme e të larmishme artistike, duke gërmuar në gjendjet dhe situatat emocionale, ideore e meditative të njeriut tonë, realitetin konkret të ekzistencës së këtij njeriu, por edhe duke shqiptuar realitetin e ardhshëm të këtij njeriu e të këtij mjedisi. Edhe pse të shkruara, romanet e lartëcekura pas viteve të tranzicionit, përafritet dhe dallimet, janë të dukshme. P.sh., romani "Shkaba", dallon krejtësisht nga romani "Aks-

identi", si për nga strukturimi kompozicional tematik i thurjes së veprës, po ashtu edhe për nga formësimi i personazheve. Edhe kur trajton e ndërthur kuptime e struktura fantastike, mitologjike apo mistike, Kadare këmbëngul që të qartësojë e zbërthejë botën enigmatike e labirintet e kohëve e të shoqërisë që pleksen me botën e njeriut e të personazhit.

Romani "Aksidenti", në bazë të përcaktimit zhanror të romanit, sipas disa studiuesve, bën pjesë në llojin e romanin policor, (ka të bëjë me krimin), por jo me romanin policor klasik. Këtë e përcjell hetimi dhe enigma që nga fillimi deri në fund. Enigma me praninë e saj, mbështjell ndodhitë e njëpasnjëshme si mjegull, ku mundësitë e zgjidhjes së aksidentit edhe përkundër gjithë atyre hetimeve, mbeten të pazgjidhura, prandaj në kuadër të kësaj, shihet edhe si roman të absurdit. Përveç temës dhe personazhit kombëtar, ndërftutet edhe personazhi bashkëkohor ndërkombëtar, tematikë që tashmë ka zënë të lërohet në romanet e dy dekadave të fundit, në dritën e frymën e aktualitetit modern edhe në letërsinë tonë. Duke qenë vetë emblemë e kombit shqiptar në përgjithësi dhe emblemë e kulturës dhe letërsisë shqiptare në veçanti, Ismail Kadare ka krijuar edhe personazhe emblematikë që shënjojnë realitete specifike thelbësore të qenies sonë brenda këtij romani. Për dallim nga veprat e tjera, të shkruara nën diktaturën komuniste, nën velin e fshehur të turp, në të cilat Kadareja nuk e ngre temën e seksualitetit, në këtë roman kësaj teme i kushton një vend të veçantë, edhe pse erotizmi këtu shfaqet shqetësues hera-herës dhe monoton, përmes zotimeve që për të tashmen janë shprehje arkaike, p.sh. "Sido që të ndodhë, unë do të të dua tërë jetën", si dhe lëmshin e shumë fshehtësive. Një libër që të tundon rreth vdekjes së personazheve (një çifti të dashuruar) për dyshimin, të fshehtë, gat-gati zhbërjen. Përkundër të gjithave mbetet një mister.

"Aksidenti" nuk i përket fushës politike, sipas disa kritikëve, edhe pse ka elemente, të cilat ngriten mbi këtë problematikë, duhet parë edhe nga kjo anë, jo vetëm ndoshta si një triller erotik? Sidoqoftë, vlerësimet, rreth këtij libri më shumë i kanë bërë shkrimtarët e huaj, e më të zëshmit ishin shkrimtarët dhe kritikët e Organizatës Pen International, kurse kritiku amerikan Çarls Mekgrath, në gazetën The Neë York Times, shkruan kështu: "Aksidenti" nuk është një nga arrijtet e mëdha të shkrimtarit dhe se lexuesit që duan të shijojnë Kadarenë në kulmin e tij, duhet t'u drejtohen librave "Ura me tri harqe" gjithashtu edhe atij "Kronikë në gur". Por që e cilësojnë si një libër mjaft interesant. Trajtohet një marrëdhënie e zakonshme dashurie, herë e ngrohtë e herë e ftohtë, varësisht nga







periudhat që kalonin në mungesë të njëri-tjetrit, apo një ngjashmëri me politikën ballkanike, gjithnjë e zjarrtë Brenda gadishullit jepet kështu "...përgjumshëm e kishte menduar shkëputjen prej saj. Herën tjetër, thoshte. Hera tjetër do të ishte edhe e fundit. Ballkani digjej, ndërkaq nga flakët dhe gjithçka vetvetiu shtyhej". Një marrëdhënie dashurie që fillon në mënyrë të papandehur dhe mbaron në mënyrë të përdhunshme. Ngjarja ndodh gjatë luftës së Kosovës, në vitin '99. Vdekja e tyre mbetet një mister, një enigmë nga e cila lindin edhe disa hipoteza me motërzime të ndryshme: Vdekja e tyre ishte një aksident? Vdekja e tyre ishte një vrasje e dyfishtë? Apo vdekja e tyre ishte një pakt vetëvrasjeje? Por mbi gjithçka, ky aksident, nënkuptohet si një aksident i veçantë.

**Besfort Y.**

Në këtë varg hipotezash për ngjarjen, nuk përjashtohet edhe varianti i vrasjes për motive politike, sepse Besfort Y., konsiderohej si armik i ish-Jugosllavisë, kurse Rovenë një viktimë e rastit që ishte gjendur në çastin kobzi. Përmes këtij motërzimi, jepet vetëm një kënd i romanit politik, ku pushteti totalitar është shkatërrues i personalitetit, i cili nuk vë fikson në shërbim të ideologjisë që tregon luftën ndërmjet njeriut - Besfort Y. dhe pushtetit - Jugosllavisë. Vetë protagonist Besfort Y. është viktimë e sistemit, ku narracioni flet për një ngjarje fatale, por që këtu nuk ndjehet doza e dhimbjes, pavarësisht dëshmvive, të cilat nuk hedhin dritë dhe kontestit ndërmjet tyre, ky roman, parë nga ky prizëm, është një reagim moral dhe njëkohësisht estetik që mundohet të tregojë, edhe pse pa përgjigje, gjendjen tragjike të shqiptarit të Kosovës në ish Jugosllavi. Për nga tipologjia futet në llojet e romanit policor, sepse vazhdimisht tërhiqet nga enigma apo misteri dhe hulumtimet e njëpasnjëshme. Nëse bazohemi tek subjekti apo tërësia e

ngjarjeve në këtë vepër letrare, ky roman i referohet baladës me pamundshmërinë e realizimit të një dashurie. Finalizohet e përshkohet edhe sfondi baladesk i Besfortit dhe Rovenës. Dashuria e tyre që në fillim merr fatin e një dashurie tragjike, edhe pse zhvillohet herë e ngrohtë e here e ftohtë, zënkat e tyre përfundojnë me butësi, flasin shpesh edhe për ndarjen, por që është e pamundur. Ndonjëherë mund të mos jenë të dashuruar, e pavarësisht kësaj ata vazhdojnë të qëndrojnë bashkë. Ata e fillojnë dhe jetojnë bashkë këtë dashuri, dhe fati fatal i po kësaj dashurie përfundon tragjikisht, me mbyetje përmes aksidentit, me vrasje apo vetëvrasje, as kjo e fundit nuk përjashtohet dot. Kjo rrjedhë e ngjarjeve epike baladeske tek sheh Besfort Y. që merr leje triditëshe nga zyra e tij në Këshillin e Europës, tri ditë leje për të kryer diçka (kërkesa e tij e fundit në këtë botë), një klishe e vjetër. Rend për të kërkuar një afat. Një përgjasim me Baladat shqiptare në përgjithësi, për të përquar një kumt tutje, apo çfarë?! Kjo, pra, të kujton marrjen leje të Ago Ymerit, një personazhi të një kohe tashmë të largët. "Hulumtuesi dëgjon-te i nemitur. Ja, leja e Besfort Y. ngjante, sipas ekspertëve, me lejen treditëshe, të njëfarë Ago Ymeri, pavarësisht se kjo e fundit ishte nxjerrë nga një burg i mesjetës e tjetra nga Departamenti i krizave, në Bruksel."

Ngjajnë me marrjen e lejes dhe paktin e fshehtë, veçse pikëtakimet dhe pikëdallimet e tyre, sipas parimeve të letërsisë së krahasuar, do të pasqyroheshin kështu: Besforti kërkon leje triditëshe, kurse Ago Ymeri kërkon leje nëntëditëshe. Besfort Y. është protagonist, i cili jeton në kohën bashkëkohore, kurse Ago Ymeri vjen nga një kohë e largët dikur, në mesjetë që ishte në një burg të Spanjës diku. Largësia vendore e njerit dhe e tjetrit personazh dihet, Ago Ymeri vjen nga një burg i largët, poashtu edhe Besfort Y. përshkon vende të largëta, nëpër

tërë Europën, një qëndrim i largët i të dy personazheve, nga juglindje në veriperëndim dhe anasjelltas. Tjetra është fjala e dhënë apo kulti i besës që njihet vetëm tek shqiptarët, ky kult madhështor që e ruajti rrjedhën e burimit te popull në secilën kohë. Shtirja kohore e këtij fenomeni jepet që nga koha e baladës, se Agoja do të kthehej pas nëntë ditësh, po ky fenomen do të përcillet edhe në kohën e sotme tek Besfort Y, se atij i duhet leja për tri ditë dhe se pas tri ditësh do të kthehet. Shqiptarët u lidhën fortë në fjalën e dhënë, lidhja për fjalën përbën autoritetin më të lartë të shqiptarit, në të gjitha marrëdhëniet, jo vetëm në fis e në besimet fetare, në nivelin e bashkësisë etnike, por edhe në marrëdhëniet ndëretnike, të gjitha ishin të lidhura përmes fjalës së dhënë. Kurse, tjetra është, se vendlindja e Ago Ymerit, Ulqini, shihet në një lidhje me një metropol të Europës, Spanjën, atë kohë. Po kështu, nënkuptohet sot, Kosova dhe Shqipëria me metropolin politik europian, Brukselin. Duket sheshazi edhe nga një letër e marrë e cituar kështu: "Në përgjigjen e tij nga Brukseli, ai kishte shkruar se ishte..., letra më e bukur që kishte mbërritur atë stinë në parlamentin europian, nga pjesa më e largët e kontinentit, Ballkanit Perëndimor, atij që mezi ç'priste të hynte në Europë". Kështu, këtu bota shqiptare, shihet në një kontekst europian dhe botëror, përmes shtirjes kohore nga e shkuara drejt së ardhmes-sot. Dallimi vetëm ekziston në fund të librit, sepse nuk përputhet cikli i epilogut jetësor të këtyre dy personazheve: Fund tragjik për Besfort Y. dhe të dashurën e tij Rovenën, personazhet e romanit "Aksidenti", kurse për personazhet e baladës "Ago Ymeri" ndodh e kundërta.

Bota dhe fati i personazheve të "Aksidenti", janë paracaktuar që në nisje të anojnë kah tragjikja, kjo është e pashmangshme. Këtu jeta dhe vdekja janë bashkë, komunikojnë njëra me tjetrën, bashkudhetojnë, pikërisht si në baladën shqiptare "Kënga e Dhoqinës", tek udhëtojnë e gjalla- Dhoqina me të vdekurin- Konstandinin. Është këputur peri kufizues që ndan këto dy botë. Personazhet e këtij romani, kalojnë nga një gjendje në një gjendje tjetër, tjetërsohen. Situatat që ata kalojnë janë paradoksale në harmoni me logjikën njerëzore. "Aksidenti" është pjesërisht roman i veprimt dhe pjesërisht roman i personazheve. Është roman veprimi, roman i ndodhive, për arsye se bartës të kësaj ndodhie, si dhe të parakësajshmes-aksidentit, bartës të të gjitha përjetimeve që paraqiten, janë dy personazhe me status të njëjtë, dy dashnorë. Është roman i ngjarjes, sepse këtu personazhet aq mirë janë të konceptuara drejt intrigës. Në secilën pjesë të romanit, do të shohim veprime të ndryshme, një ngjarje shpie tek tjetra ngjarje, duke kërkuar zgjidhje të konfliktit. Kurse nga ana tjetër, shohim që personazhet nuk janë shumë të pavarura nga ngjarja kryesore në roman, dhe se reagimet që bëjnë ata, herë janë tipike dhe herë të qëllimshme.

**Rovenë**

Përshkrimet në roman, jepen në dy drejtime, përshkruhen karaktere personazhesh dhe veprimesh. Ato kryesisht jepen në vetën e tretë njëjës, po ashtu përshkruhen hapësira të ndryshme, në të cilat zhvillohen ngjarjet e romanit. Hapësirat, vendet e

këtyre ngjarjeve, janë të ndryshme, po që vetëm një është ambienti përbërës i tyre, hotelier. Ja se si e pohon rrëfimtari këtë, përmes kujtesës së kryeprogonistit, Besfortit, "Ndër mend, kushedi pse, nisën t'i renditeshin emra hotelesh, ku kishin fjetur të dy, Piazza, Interkont, Pallace, Don Pepe, Sacher, Mariotte." Dialogët e ndryshëm e të shumtë, të cilët vijnë herë të zbehtë e herë mjaft të gjallë, këtij romani i japin edhe dramacitetin e duhur. Dialogohet për dashuritë, besnikëritë, tradhëtitë, marrëzitë, lirinë, luftën, frikën, dëshminë, misterin etj. Monologu i brendshëm i personazheve në këtë roman të Kadaresë, shfaqet jo rrallë, por që secili çast i shfaqjes së monologut, është i veçantë në ngjarje dhe përjetime të personazheve, siç vjen e veçantë edhe kjo frazë nga brendësia e Rovenës "Sa letra i kam nisur e i kam grisur, sa monologë më kanë lodhur në vetmi." shumta, apo lokale ditore, dikur u bënë të zakonshme, në fund, morën formën e një rituali kohor. Përmes retrospektivës së rrëfimit, hapësirë më e madhe, gati tërësore, u është dhënë Besfort Y. dhe Rovenës, një çift endacakësh, të cilët kishin nëntë vjet bashkë, "Kishin nëntë vjet bashkë. Gjithçka ia kishte dhënë këtij njeriu".

Besfort Y., kryeprogonisti së bashku me Rovenën, një çift nomadësh që enden përgjatë Europës. Rovenë e veçantë, shpalo çiltërsinë, karakterin e veçantë femëror, të vërtetën, pa asnjë kompleks. Narratori, përshfaq Rovenën e dyjetshme, si Rovenë dhe si Anevor (anagrami i emrit). Këtë lojë ndryshimesh në emra, lexuesi e ka të njohur, sepse anagramin Kadareja e përdori edhe për personazhin e romanit "Shkaba" është fjala për Anën: "Tani që brenda, "Ana" lexohej "anA". Rovenë, vajza, e cila jetonte mes dy planetësh, mes dy hapësirave biseksuale. Si shumë vajza dhe gra të reja në këtë botë, ajo zhvendosej lehtë nga gjendja e robinjës tek ajo e mbretëreshës, ose anasjelltas, pa gjetur dot vendin e saj të natyrshtëm. Besfort Y., burri shqipar, natyra e të cilit tregon kodin moral të epërsisë gjinore në lidhjen e dashurisë me Rovenën. Por si çdo natyrë e vështirë burri, ndihej i vetmuar në këtë botë, pabesia nga ai përjashtohej, ashtu si në dashurinë e vjetër, e bashkë me pabesinë përjashtohej edhe ndarja. I vetëdijshëm, se lidhja e tij pasiononte me Rovenën, s'mund të vazhdonte edhe pa rrezikun e humbjes. Me këtë nuhatje prej burri, ai vendosi ta ndante dashurinë e tyre në dy faza, të parën fazë, të sigurtën, por që tashmë ishte e humbur, dhe fazën e dytë, kur femra që shoqërohej me të, nuk ishte më Rovenë e dashura e tij, por thjesht një call girl (vajzë qejfi). Ai jetonte me dyzimin dhe nuk dyshonte për këtë, aq sa i shmangej asaj, aq edhe joshej po nga ky mëkat. Numri i personazheve që përbëjnë ngjarjen e romanit dhe bartin veprimet, nuk është i madh. Ata janë pak, Besfort Y., Rovenë, Liza Bllumberg, hetuesi, ngasësi i taksisë dhe jevga Zara. Kadareja në këtë roman, vjen i veçantë me diskursin erotik, pikërisht përmes rrëfimeve nga Jevga Zarë. Ajo paraqet të ndryshmit dhe të gjithë ata që ishin të sojtit të saj, që përbëjnë shoqërinë e një vendi të vogël, të cilët për gati pesëdhjetë vjet e patën të ndaluar ta pohanin. Por që tani ishin rikthyer nga viset e largëta, të skajshme të internimit, ku gjithçka dukej edhe shprehej.



**LETËR E PADËRGUAR**

A e di se rrufetë e mallit tim për Ty,  
përplasen dhimbshëm brenda zemrës,  
e dashur motër?  
Dhe nëse ti vonohesh  
këto rrufemalli një ditë do të ma ndalin zemrën.  
Ndaj, të lutem mos e vono ardhjen tënde.

Përse nuk u bërë dallëndyshe këtë pranverë  
të më cicërije dritares sime me një fjongo në sqep  
sjell nga fëmijëria?..  
Përse kripëmjalhtëza ime ?...

Oh, sa vite u bënë pa erën tënde,  
lodhem t'i numëroj...  
Ndaj eja shpejt ta tresësh renë e mallit tim,  
ta prekësh me mollëza gishtash, duarsh,  
ta ndjesh dhimbjen time vetmitare  
tek rrëshqet syve, faqeve  
duke kërkuar prehjen.

Mos u vono, motër  
Mos eja atëherë kur fryma ime të kthehet ajër,  
sepse atëherë  
do të jetë vonë.

**SI JO ÇDO GRUA**

Dashurohem përditë me ty,  
edhe kur mes nesh hyn dimër i acartë.  
Me frymën tënde mbush jetën time  
gjelbëroj si pemë, kthehem selvia kryelartë...

Dashurohem me ty përditë,  
me përrenjtë e dhimbjeve të tua, gjithashtu  
edhe atëherë kur ndjej si shpërthejnë stuhitë,  
si ndizen rrufetë e digjen syve të tu.

Dhe shpesh gjëmoj brigjeve të tua,  
si valë e drojtur, dallgë e trazuar,  
Por unë të dua jo si çdo grua,  
dashuria ime me frymë e gatuar.

**MË DUHET...**

Për të të uruar Ty,  
më duhet të lëndoj kujtimet  
të kafshoj plagët e mbetura  
nëpër hojet e zemrës,  
që dikur hovte prej mallit,  
dashurisë,  
pritjes...

Më duhet të mbyll sytë  
për të mos e parë më, rrezen e diellit  
që zgjonte trupat tanë  
mbështjellë me lëkurë dashurie..

Më duhet  
të mos e shoh rënien e yllit tim  
pagëzuar prej buzëve, syve, gishtave.

Për të të uruar Ty,  
më duhet të harroj  
mëngjeset me aromë bugaçeje,  
shëtijtjet këmbëzbathur thellë pyllit fletëgjerë  
gjalluar nga puthjet e zogjve,

Më duhet të harroj tinguj, aroma, emra,  
stacione, rrugë, shitore,  
shtrëngime duarsh, shikime  
ikje, fluturime.

Për të të uruar ty,  
më duhet të mbys klithmat e shpirtit,  
që çahet dhimbshëm  
kur shoh pranë teje tjetër grua.

Më duhet të harroj vetveten.  
të shkel mbi zemrën time,  
për të të thënë  
"qofsh i lumtur, pa mua".

**METAMORFOZË GRUAJE**

Unë jam një Beatrice me sy të trishtë,  
me zemër të përflakur nga dhimbja e harresës..

Unë jam një Penelopë  
që harrova diku pëlhurën e bardhë  
me shenja gishtash,  
buzësh,  
shpirti,  
dhe era e vari si velë ullinjve të paqtë.

Unë jam Kleopatra,  
që kurrë nuk rreshti të ndiqte yllin e zemrës së saj.

Jam një Karmen,  
që fle dhe zgjohem e prushtë,  
e ëndërrt,  
e përkëdhelur me frymë dhe mall,  
ngjizur nga limfa e bardhë...

Jam një trill, një orë e çmendur, një zanë,  
jam dhimbja, marrëzia,  
dashuria jote.  
Jam shpirti i trazuar i kësaj bote...

**A E NDJEN?**

A e ndjen,  
si shëmben idhujt,  
si rrëzohen ortekët e zemërimit  
kur unë të them "të dua" ?  
Si tërhiqen skutave të errëta demonët  
dhe heshtin ?

A e ndjen,  
si shkrijnë akujt,  
si bie pluhuri i dhimbjes nga sytë  
kur unë sodis e etur me sy e duar fytyrën tënde...  
Kur unë të puth  
dhe ti përndritesh i tëri si Diell?

**MOS HARRO!**

Nëse ti më harron...  
edhe shiu do të harroj të ndalet  
dritareve do të zhurmojë me trishtim,  
era do t'i thyej kërcejtë e gjelbër që porsambinë...

Nëse ti më harron,  
ditët e mia s' do të kenë më emra,  
syve të mi do të shtohen re pikëllimi,  
(si krahë lejlekësh të trishtuar).

zemra do t'gjëmojë nga thirrjet e humbura,  
brenda saj e kuaja e zambakëve do të venitet.

Nëse ti më harron,  
koha do të thinjet nga pritjet.

**NDJESHMËRI**

Më dhimbsen krahët e zogjve mbi pemë,  
Kur bie pjalm i borës,  
më dhimbsen sythi ende i pambirë  
ngjizur në zemër thellë tokës.

Kur bie pjalm bore,  
më ngrin qerpikëve merakun për ty  
ndjek lotin e kristaltë që rrugëton mbi xham...  
ti me gishta prej akulli më shkruan,  
"mos u mërzi, të kam xhan".



**TI SHKRUAN POEZI, UNË VETËM VENDOS EMRIN!**

Nuk kam i fuqi të të ndryshoj  
dhe as të të shpjegoj...  
Mos beso asnjëherë se burri mund të ndryshojë një grua,  
dhe as fantazitë e burrave që pretendojnë...  
se kanë krijuar gruan nga brinja e tyre.  
Gruaja nuk mund të dalë nga brinja e burrit,  
por është burri ai që del nga barku i saj  
Siç del peshku nga thellësitë e ujit.  
Është ai, që shpëputet prej saj  
siç ndahet rrëkeja prej lumit  
Është ai që sillet rrotull diellit të syve të saj...  
dhe i ngjan, se qëndron në zyrë i ulur.

Nuk jam i aftë të të mësoj asnjë gjë,  
kraharori yt është mishërimi i dijes,  
buzët e tua janë mishërim i historisë së verës...  
Ti je një grua e plotësuar  
Vaji yt, është prej teje  
Gruri yt, është prej teje  
Zjarri yt, buron prej teje  
Vera jote, dimri yt,  
vetëtimja jote, bubullima jote,  
shiu yt, dëborja jote,  
dallgët e tua, valët e tua...të gjitha burojnë prej teje.

Unë s'kam fuqi të të zbus,  
dhe as të ndryshoj instiket e tua...  
ky është një mision i pamundur.  
Testova me ty inteligjencën time  
Dhe marrëzinë time gjithashtu.  
Por as udhëzimet, as joshja nuk solli dobi.  
Qëndro primitive, ashtu siç je.  
Qëndro e qeshur, ashtu siç je.  
Qëndro e vrullshme, ashtu siç je.  
Ç'do t'i mbetej Afrikës,  
nëse i marrin erëzat, apo tigrat e saj?  
Po gadishullit Arabik ç'do ti mbetej,  
nëse prej tij marrin burimet me naftë...  
ose hingëllimat e kuajve Arabë?

Unë nuk kam fuqi, ti thyej zakonet e tua,  
e tillë je ti, prej tridhjetë vitesh,  
prej treqind vitesh,  
prej tremijë vitesh...  
Je një stuhi e mbyllur në shishe,  
një trup që e ndjen aromën e një burri natyrshëm,  
që e sulmon atë natyrshëm,  
Dhe që natyrshëm fiton mbi të.

Mos iu beso fjalëve që burri thotë për veten:  
Se... "është ai që i shkruan poezitë",  
Se... "është ai që i bën fëmijët"...  
Në fakt, është gruaja ajo që i bën poezitë  
burri vendos vetëm emrin e tij në fund.  
Është gruaja ajo që sjell në jetë fëmijët,  
ndërsa burri vetëm firmos në maternitet...  
që është bërë baba.

Unë nuk jam i aftë, të ndryshoj natyrën tënde,  
tek ty, nuk ndikojnë librat e mi.  
Bindjet e mija, nuk të bindin ty,  
as këshillat prindërore nuk kanë dobi.  
Ti je mbretëresha e kaosit, e marrëzisë, si përket askujt...  
Atëherë, qëndro e tillë!  
Ti je pema e feminilitetit që rritet në errësirë,  
që s'ka nevojë për ujë, as diell.  
Ti je princesha e detit, që deshi të gjithë burrat,  
por nuk deshi asnjërin.  
Që ke fjetur me të gjithë burrat, por s'ke fjetur me asnjë.  
Ti je gruaja beduine, që ka shkuar me të gjitha fiset  
dhe është kthyer e virgjër.  
Qëndro kështu siç je...

**NJE LETËR NGA NËN UJI!**

Në qofsh miku im më ndihmo  
që të largohem nga ti.  
Në qofsh i dashuri im, ndihmomë  
të shërohem nga ti.  
Nëse do ta dija dashurinë kaq të rrezikshme,  
nuk do dashuroja.  
Nëse do ta dija detin kaq të thellë,  
në të, s'do lundroja.  
Nëse do ta dija se ky është fundi  
kurrë nuk do filloja.

Më përzhiti malli, ndaj mësomë  
të mos përvëlohem.  
Më mëso si ti pres gjer në rrënjë  
rrënjët e dashurisë për ty.  
Se si vdes zemra, si vetëvritet dashuria...  
Mësomë, si vdes loti në sy.

Në ke fuqi, më shpëto  
nga ky det me stuhi,  
sepse nuk di të notoj.  
Dallga blu në sytë e tu, më tërheq thellë e më thellë.  
Dhe unë nuk kam përvojë në dashuri,  
nuk kam as ndonjë varkë të lundroj.  
Në më ke të shtrenjtë, zgjatma dorën.  
Unë jam e dashuruar në ty, kokë e këmbë,  
aq sa po marr frymë dhe nën ujë.  
Unë po mbytem,  
po mbytem,  
po mbytem...

**E PARA FEMËR, I PARI BURRË!**

Më ngjan, sikur je e para femër  
që u shfaq prej miliona vjetësh.  
Dhe unë - i pari burrë që dashuroi një grua  
që prej miliona vjetësh.  
Mendoj se e njoh mirë k'të fytyrë, këto buzë.  
Se...gjatë pushimeve, mbledhja pambuk te bardhë  
në pemën e shtatit tënd të lartë.  
Më ngjan sikur të pashë këmbëzbathur k'të mëngjes  
teksa dilje nga thellësitë e detit  
e stolisur si nimfë e mermertë.

Më ngjan, sikur të kam dashur para ekzistencës së dashurisë...  
që kam shkruar poezi, përpara ekzistencës së poezisë,  
përpara çlirimit të Shamit.  
Më ngjan, sikur u martova me ty,  
dhe fëmijë në ngjyrë ëndrrash sollëm në jetë  
Shkruam poema, poezi dhe yje...  
shtuam një fis me pëllumba dhe drerë.

Më ngjan, sikur të kam takuar  
përpara kohës së Kananëve,  
përpara epokës Greke,  
përpara epokës Fenikase,  
para matjes së kohës dhe emërtimit të ditëve  
Më ngjan, sikur ke qenë gruaja ime  
që prej miliona vitesh.

**LETRA E TETË!**

Vallë, cila je ti moj grua?!  
Moj e futura si kamë në historinë time të jetës.  
Moj e bukura si sytë e lepurit.  
Moj e buta si pushi i pjeshkës.  
Moj e brishta si degë jasmine.  
Moj e pastërta si gushore fëmijësh.  
Moj e mahnitshme, si fjalët...  
dil nga fletët e fletoreve,  
nga çarçafët e shtratit tim.  
Hiq nga filxhanët e kafeve,  
nga lugët e sheqerit, dil.  
Dilmë nga kopsat e këmishës,  
nga të palosurat e shamisë së dorës  
Nga furça ime e dhëmbëve,  
nga shkuma e sapunit të fytyrës...  
Dil nga të gjitha gjërat e mija të vogla,  
që të mundem të dal për në punë...



# FUSTANI I TRËNDAFILTË

Ermelinda Alushani MYZEQARI

Më tremb morali i cenueshëm nëpër të, më tremb të qenët e pamoralshme. Kam frikë prej lëkurës sime, e cila rrudhet çdo ditë-natë platitëse. Ndjesi e ardhur nga ecja në rrugë, nga dielli dhe nga afshi i të 50 vite -jetë të miat. Flokët e prerë shumë shkurt, gati në zero më tregojnë më të vogël, në të vërtetë gjysma ime ndihet më e re dhe akoma e dëshiruar për jetën dhe në gjysmën tjetër prej formave të trupit tim gjetherënës, vjeshtë-dimri të nxira pa zë, në heshtje për atë të bukurën e harruar ndër vite. Gjysma ime në këmbën e varrit që në lindje e deri në vazhdimësinë e vdekje-jetës.

Ai, fustani plot trëndafil, ai që unë vishja kur isha e re...e këmbëzbathur vrapoja herë në shtrat të lumit e herë në breg të detit. Pastaj, e gjendur në rrugë, me këmbët e mia lakuriqe më zinte makthi i turpërimit para të tjerëve, mbuluar me gjethe të zverdhura lisi, shkërmoqur nën ecje kapitëse mundimshëm në kapje të galopit të më të shpejtit kalë të egër në pyll. Kam frikë, ai fustan, më rri tepër i ngushtë e unë...unë nuk kam një vajzë që t'ia trashëgojë fustanin tim të rinisë. Kjo ëndërr të merr frymën...

Dita e parë.

Vizitë në Panteonin mistik në Paris. I lartë, autoritar nën himnin e muzikës kishtarë, magjepsës në mesazhin ndjella-ëndës në muralet me mozaik historik, heronjsh e mitesh e ca hapa më poshtë, në katin përdhes të gurëzuar në pllaka mermeri, me gdhendje emrash e nderimesh, të lidhur me zinxhir e vendosur në gjysmë - dhomëza personale njerëz me vlerë të Historisë Franceze. Diku, midis tyre gjeta Volterin. Krijova një lidhje me fëmijërinë time. Sytë me xixëlluan, pëshpërita, Volteri..., në bibliotekën time prindërit e mi e kishin blerë para 40 vjetësh. Sërish takimi me të, por tani jo në fjalët e tij të mençura, ku në mendjen e një adoleshenteje 14- vjeçare bënin përshtypje dhe dallim me të tjerë libra të lexuar në periudhën komuniste, por si vlerë e kombit francezë, ku vete Franca di mrekullisht t'i vendosë në pedestal. M'u kujtuan Piramidat e Egjiptit për analogji dhe po ashtu Murimi i Rozafës në themelet e Kalasë së Shkodrës. E vërteta e Volterit, pushteti i Faraonit, vetëflijimi i Rozafës tashme kishin zënë rrënjë myshku ëmblandjellës nën tokën pjellë të tyren.

U ngjita sërish në katin e parë e ngazëllyer, e riciklova veten nëpër copëzat e mureve-jetë herë këtu e herë atje, e ndonjëherë në askundin e asgjësë dhe... dola e lehtësuat. Drita e diellit e rrallë në ato ditë janari në Paris, shkëlqente. Qyteti i të dashuruarve më fali copëza nga vetvetja. Qesha dhe qava nën zë.

Dora e tij, e rëndë, mashkullore u hodh mbi supet e mia dhe më ledhatoi ëmbël, më pa në sy thellë dhe më puthi në ballë, pastaj për një çast në hundë dhe buzë. Me buzë më preku sërish nën rrezën e veshit dhe pëshpëriti: kjo është hunda, buza ime, kjo



është gruaja që unë dua. Ai ishte thünjur i tëri, por vazhdonte të ishte tërheqës dhe mashkullor deri në dëshirim. Shkallët po zbrisnim ngadalë dhe mbrapa lamë atë madhështi vlerash dhe historie, shoqëruar nën muzikën kishtarë. Atje brenda dukeshin një. Të mençurit, trimat dhe hyjnitë nën një çati vlerësimi e përlujtje, dhe ne, të vegjël, midis tyre me hapa ngadalshëm kundruall tyre.

E mban mend?...- më tha.

Ngadalësoi hapat, më pa në sy dhe shkallët nuk kishin mbaruar akoma. Më mori në krah dhe më uli ngadalë në sheshin ku mbaronte zbritja. Në këto momente ishte i tëri i imi. Qeshte dhe me krenari së fundmi thoshte: - e po, akoma mbahem e fuqitë s'më kanë rënë hala për gruan time. Qesh triumfator dhe më puth në buzë.

Për herë të parë kur u takuam të dy, ti shkëlqejte me atë fustan, dukeshë sflitëse në bukurinë tënde natyrale. Të rrinte pas trupit dhe flokët e gjatë, të zinj dhe të lëshuar pas shpinës, derdhehin shkëlqyeshëm. Më more më qafë! -tha - dhe sa mirë bëre. Unë e ndjeva, ai ishte pranë meje dhe po me përpinte të tërën me shikime. I gjatë, elegant 22 vjeçar, me sy të thellë dukej sikur po me lexonte gjithë brendësinë time, kush isha, sa vjeç, ku studioja... Zemra më rrihte mbytur nën zë dhe duart e djersitura përpiqesha t'i fshija duke shtrenguar çantën e vogël. Unë studentja 19-vjeçare për herë të parë e ndjeva se isha e zënë në grackën e ëmbël të dashurisë. Në të vërtetë m'u deshën pesë muaj për ta kuptuar këtë. Pesë muaj që do të ndryshonin jetën time përgjithmonë...

Buzëqesha, hodha sytë lart drejt shtyllave gjigante dhe më dukej sikur zbrisja mes kohësh, ëndrrash e kujtimesh pa fre. Dola në shesh, u

rrotullova si një 5-vjeçare, e ndërkohë palltoja blu me peliçen rreth qafës, me shkëlqim më përkëdhelte në atë vend madhështor. Ndihesha e përkëdhelur në botën time femërore, me atë çka më kish ngelur deri më sot, në përballje me Parisin e ëndrrave të dashurisë. Mbetja femërore e veshur nën hije kujtimesh veshjesh mashkullore, unike para viteve 90-të. Gra të rënda ushtarake, kooperativiste dhe femra që vidhnin në kooperative dhe në ushqimore, për t'i futur nën bluza e nën sutina për të ushqyer pak më mirë fëmijët e tyre. Dhe mbas viteve 90, një veshje lakuriqe ku gungat e deformuara të grave ndër vite në emër të lirisë shpërthyen dhimbshëm. Copëzat e fisnikërisë u copëtuan. Ndërkohë u rrita në këto mbetje imazhesh, e ç'mund të isha unë...Kundruall meje nëna ime, e bukur dhe fisnike luftonte për brishtësinë time. Modeli i saj deri në stocizëm synonte përsosmëri nëne dhe femre.

Rreth vetes, sot.

Unë, mesogrua, vëzhgoj mbi veten, lëngimin ndër rrënjët e gjakut tim të shtrira padukshëm gjithkund dhe askund. Sa ngrohte rrjedh ai gjak nëpër deje. Kam frikë për lirinë e lartë nëpër breza rritur. Shkapërdërdhur degëzimet nëpër të, e sosur kushedi se ku...

Ne vilajetin e Ali Pashës, te Molla e Kuqe, në Prishtinë a Selanik, në Gjerbes, Gramsh, Lushnjë, Tiranë e Amerikë e kukamfshëti nëpër shekuj kushedi se ku.

Të kapur pas degëve të holla, ngatërruar nëpër erëra kohërash të egra, pinjolle në këtë lis të hershëm, përpiqemi dhe mbijetojmë në tymnajtë e të sotmes. Prej 1800-ës, ky lis me rrjedh gjaku u vendos në Gjerbes, rrëzë Tomorrit. Erëra të forta fryjnë në ato anë, borë, shira e rrekëza uji që

rrjedhin prej shpateve lart. Këmba të ngjeshet nën borë dhe frika se deri ku është caku i shtegut, të bën të dridhesh se edhe mund të rrezohesh kushedi se ku, atje poshtë nëpër humnera, fshehur nën petkun joshës të dëborës së madhe. Duhet t'i njohësh mirë ato shtigje. Arrat dhe lisat, copa shkëmbinjsh shekullorë, të ngurtësuar njësh midis dheut dhe qiellit. Madje, edhe arinjte e murrme, thonë se janë shtuar në ato anë. Në pllajën e varreve, të vdekurit mbartin së bashku me shpirtin e tyre të thënat dhe të pathënat e njerëzisë. Natën, nëse hap derën, del jashtë, dëgjon një fëshfërimë ere me afsh bore, përzier me rrëfime shpirttrash tashme të prehura qetësisht në paqe prej qemoti: luftëra hasmërie, plagë, vdekje. Lëngime sëmundjesh, marrje jetësh para kohe. Dasma e gosti. Të moralshëm e të pamoralshëm. të gjithë përzier në atë bote, për qejf e për hall uleshin kundruall njeri-tjetrit e herë ia merrnin këngës e herë ia merrnin kujës. Herë në pasuri e herë në skamje, herë me të keq e herë me të mirë mbijetonin. Të pashëm ishin burrat e fisit, trima, të zotë, por edhe gjaknxehtë që ta merrnin jetën me kamë në dorë. Të urtë rrinin në qoshe, flisnin pak e dëgjonin shumë. Nuset nëpër këmbë ju shtronin sofrën, lanin e shpëlanin por dollinë e këngën e merrnin më mirë se burrat. Të trembte to tipari mashkullor. Prej tyre ke frikë, ke respekt. Të jesh thjesht sensual besoj se për to s'mjafton. Ato duan t'ia marrin valles me të njëjtin hap e ritëm me burrat. Vërtet prej tyre duhet të kesh frikë. Kanë një forcë të çuditshme. Nga ai lis i lashtë kushedi se ç'buron... në kohët moderne duket sikur botës po i kthejmë borxhin, po ikim andej nga kushedi kemi ardhur shumë kohe më parë. Po i lëmë të zbrazëta nën akullsinë e mermertë ato dhe këto anë. Dhimbshëm nuk e dimë saktësisht nga kemi ardhur të zhgënjyer e nuk e dimë se ku po shkojmë. Vetëm ata janë stoik, të vdekurit nën petkun e ftohtë të rrasës së varrit, karshi pllajave të përzgjedhura për pak më shumë rrëzë dielli.


Fustani im i trëndafil... a do t'u bëjë nuseve të djemve të mi ai fustan?! A do të duan të veshin ato fustanin tim?! Kam frikë prej mendimeve të mia. Kam frikë edhe prej mendimeve të të tjerëve. Të gjithë më kthejnë në lërmsh dhe unë rrotullohem në kuturu. Kuturuja s'më çon asgjëkund. Po dhe unë... çfarë dua... , nusët e mia të veshin fustanin tim?!... Është e tepërt, ato nuk mund të jetojnë në kohën time.

Kujdes prej mendimeve ka thënë Znj. Theçer, ato mund të kthehen në fjalë, veprime, me pas në zakon, më pas në karakter. Ndaj unë kapem fort pas rrugës, nuk mund ta humb atë. S'ka se si të ndodh ndryshe, unë, s'mund të eci kuturu dhe mendimet s'duhet të më mbysin ëndrrën për të jetuar. Megjithatë, unë prapë kam frikë. Por frika më gëzon. Ajo ma ngjeth trupin mornicash të ngrira. Ajo të dhemb e kështu më bënë të ndihem gjallë. Ajo më bënë të ndihem më femër nga mplakja.



# PROJEKT ME TËRËSINË E VET

(Rreth librit: *Arti i këndimit dhe pedagogjia vokale, të autores-solo këngëtares Elife Podvorica-Jashari*)



**Samir PIRAJ**

Libri "Arti i këndimit dhe pedagogjia vokale" i autores Elife Podvorica-Jashari, i cili tashmë është në duar të lexuesve, përbëhet nga një strukturë interesante homogjene e spektrit të anatomisë së organeve të frymëmarrjes që sintetizohet në këndimin e drejtë apo më mirë të themi në artin e mirëfillt të këndimit.

Libri është i formës së eksplorimit shkencor, por edhe narracionit, i cili gërshetohet me eksplorimin e anatomisë së frymëmarrjes, dhe shërben para se gjithash për orientimin e drejtë të pedagogëve të këndimit, e deri tek recipienti i fundit që është vetë nxënësi pse jo edhe studenti i solokëndimit. Diskursi i shkoqitjes pragmatike të artit të këndimit, të kësaj zeje intelektuale do ta quaja, ka zanafillën shumë herët, por tek ne, mbase është në fillimet e shtjellimit teorik dhe praktik në baza shkencore. Nuk do të themi se mënyra e qasjes për këtë shkoqitje logjike ka munguar, por një argumentim i stërholluar me shembuj dhe orientim të disiplinuar dhe të natyrshëm, është padyshim i mirëseardhur dhe tejet i nevojshëm në këtë disiplinë muzikore. Autorja Elife Podvorica-Jashari, është pedagoge e lëndës së solokëndimit dhe interprete e spikatur e shumë veprave muzikore. Me performancat e saja skenike ka lënë gjurmë në jetën tonë muzikore. Pse e themi këtë? Sepse janë këto përvoja dhe argument i nevojshëm për një domosdoshmëri të trajtimit të kësaj lënde, për të bërë më të natyrshëm mësimin praktik, pse jo edhe teorik, në ambiente të ndryshme. Librin e saj e fillon me një mendim të nxjerrë nga Enciklopedia britanike duke theksuar se: Instrumenti i këndimit, është vetë trupi i njeriut me organet e tij. Shikuar më gjerësisht,

mbase vetë autorja, sugjeron se, këndimi është një nga vlerat që njeriu e disponon dhe e mbruan si qenien e vet të rëndësishme. Libri në mënyrë të stërholluar vë në pah komponentët që përfshihen në studimin e artit të këndimit siç janë: zëri, anatomia dhe psikologjia të cilat mpleksen në procesin fizik për këndimin, frymëmarrja dhe mbështetja e ajrit-apoggio, postura e trupit gjatë këndimit, fonacioni, ambitusi i zërit, klasifikimi i zërit, regjistrat e zërit, rezonatorët e zërit, diksioni dhe artikulimi. Më tej ajo ndalet tek komponentët e rëndësishme të këndimit vokale siç janë: kordat e zërit, trakti vokale (laringu, faringu, hapësira e hundës, sinusëve dhe gojës), ngrohësit e zërit - rezonatorët (hunda dhe goja). Kurse për zërin e njeriut autorja me të drejtë citon kompozitorin italian me famë botërore, Gioachino Rossini: "Zëri është akumulim apo kompleks i të gjithë tingujve, të cilët njeriu i shfrytëzon përmes organeve vokale të tij".

Dallimi në mes të folurit dhe këndimit si një element bazik të shtrirjes së materialit dhe karakteristikave qenësore për të argumentuar proceset që vijnë, në librin: "Arti i këndimit dhe pedagogjia vokale", argumentohet me fakte relevante, me natyrshmërinë e rrëfimit strukturor dhe fotografi shkencore. Autorja, nuk bënë asnjë veprim pa pasur bazën shkencore dhe argumentin e studi-

meve të njohësve të kësaj fushe shkencore. Literatura e bollshme e autorëve me renome, dhe vlera shkencore e cila merret për bazë në krijimin e tërë strukturës organizative të materialit të eksploruar në këtë libër, bënë që vlerësimi të jetë maksimal, pse jo edhe joshës për recipientin. Mbindërtimi shkencor që është parashtruar në faqe të tëra, në mënyrë të argumentuar, është impuls drejt krijimit të imazhit për këndimin e drejtë. Nuk janë të lehta për t'u zbatuar këto fakte, që janë të paraqitura goxha detaishtë në librin në fjalë. Natyrisht se kërkohet një zbatim korrekt, pastaj një dije paraprake dhe në fund gjithësi kohë dhe hapësirë për t'i jetësuar këto në praktikë. Libri "Arti i këndimit dhe pedagogjia vokale" mund ta quajmë edhe si një projekt, apo si një sistem që ka tërësinë e vet. Pse e themi tërësinë e vet? Sepse detajet janë pjesë integrale. Madje, po të shikohet me gjuhën e argumentit të tekstit dhe të fotografive, këto detaje funksionalizojnë përmbajtjen dhe strukturën homogjene të librit. Mund të themi pa mëdyshje se ky material i mbështetur në argumente shkencore siç thamë më herët, ka një sistem, një plan narrativ, një strukturë të përcaktuar mirë e mirë për një funksion artistik, që është dhe mbetet qëllimi kryesor i tërë kësaj pune të vështirë por gjithësi të dobishme për të gjithë ne dhe gjeneratat në vijim.

## Reflektime

# LETËRSIA E MIRË ËSHTË FANTASTIKE

Vetë letërsia botërore fillon me dy kryevepra letrare të cilat, i përkasin kryekëput zhanrit të letërsisë fantastike. Iliada dhe Odisea

**Artur SPANJOLLI**

E gjithë letërsia e mirë është fantastike. Duke filluar nga Eposi i Giglameshit, Homeri, Dante, një pjesë e Shekspir, Don Kishoti, i cili ka elemente thellësisht fantastike, Gëte me Faustin e tij një pjesë e letërsisë franceze, Virginia Wolf me Orlando-n e saj suprem, letërsia e realizmit magjik latinoamerikan. Nga Markezi, Borgesi, Rulfo, Alende, Asturias, Paz apo Ljosa, etj. E kështu me radhë përrallat, Njëmijë e një netët, Liza në botën e çudirave, Harry Potter, Princi i vogël, Udhëtimet e Guliverit, Rabele me: Gargantua e Pantaguel, etj etj, etj. Letërsia e mirë duhet të jetë fantastike. Duhet medoemos të jetë një produkt alternativ i jetës. Një rikrijim i saj. Jo një kopjim besnik saj. Por doja të thoja, se e gjithë letërsia, si alternativë e krijuar nga fantazia njerëzore, është fantastike, edhe kur ajo riprodhon ose rikrijon jetën pa e përzier pra me elementin mbinjerëzorë. Kur lexojmë një Balzak, Hugo, Tolstoj apo Xhejms, edhe pse këta autorë na e japin realitetin siç e njohim, pa elementin fantastik; sido që të jetë, edhe këto romane realiste, ndryjnë brenda tyre, medoemos elementin fantastik. Ato janë sajesa alternative, paralele, të ngjashme me jetën reale. Ato pra, edhe pse ndjekin ligjet e jetës, siç e njohim, ato mbeten gjithmonë. fryt i fantazisë, pra i letërsisë fantastike.

E gjithë letërsia e mirë, do të më pëlqente t'i drejtohej intuitës, asaj ane të trurit, e cila merret me fantazinë, imagjinatën. Ajo është dhe duhet të jetë, produkt irracional i ëndrrës, i rastësisë, i krijimit letrar dhe jo veç i logjikës së ftohtë racionale. Kjo është edhe arsyeja pse letërsia analitike e Dostojevskit më intrigon, më josh dhe më bën të mendoj, të reflektoj, por nuk më bën ta dua atë thellësisht, përjetësisht. Nuk bëhem dot "dashnor" i saj. Preferoj Tolstoj-in. Vetë letërsia botërore fillon me dy kryevepra letrare të cilat, i përkasin kryekëput zhanrit të letërsisë fantastike. Iliada dhe Odisea. Dhe veç për Odisea-n, si kryevepër e kryeveprave, mund të flisja, për orë të tëra.

Letërsia e Borgesit për shembull, është fryt i intuitës, i imagjinatës, është një koncentrat ëndrrë, krejtësisht irracionale dhe fryt i pandërgjegjes. Dhe është pikërisht tek ato intuicionet e tij, ku qëndrojnë edhe grimcat e një gjenialiteti të pasqor. Një gjenialitet krejt origjinal. Borges nuk arrin në konkluzione, dhe ndoshta as nuk i interesojnë fare, ato, ai veç provokon, hap shtigje të reja, eksploron të paeksploruarën. Borges, duke punuar, duke u marrë pra, me konceptet, mundohet të na ofrojë një botë alternative; e rikrijon atë duke e elaboruar dhe vëzhguar mirë në laboratorin e tij krijues. E gjithë letërsia e mirë është fantastike. Ajo duhet të jetë fantastike.





# ARKA JONË E RE E NOES

Sot bota perëndimore njihet bankën etike, ndërmarrjen etike, tregtinë e komunikimin etik, tatimet etike, politikën, madje dhe financat etike

Gersa RRUDHA

"Etika është fjalori i perëndimit" - shkruan Pol Rikër, filozofi më i madh bashkëkohor francez, "e në erën globale ajo kthehet në mjetin e vetëm të orientimit". "T'i rikthehemi etikës. Të kapemi pas saj si pas një argshi në mes të një stuhie. Se ajo është arka jonë e re e Noes". Ja, kështu shprehej në një mbrëmje vjeshte parisienë të vitit 2001, filozofi i madh gati njëqind vjeçar Zhan Guitton (nxënës i Bergsonit dhe mik i ngushtë i Papa Palit VI).

## Etika

Ja, kjo është situata kah se cilës drejtohet sot kjo disiplinë fisnike e filozofisë. Ja, përse zërat më të shquar të mendimit perëndimor kanë hedhur tezën e ekzistencës së një "urie për etikën në shkallë botërore", ndërkohë që filozofi i njohur francez, Edgan Morin, vlerëson se "pavarësisht nga progresi impresionues i teknologjisë, ndodhemi të gjithë në një Titanik Planetar, pasi mungon pikërisht një vizion etik që udhëheq procesin". E kjo sepse në thelb, është pikërisht etika ajo që duhet t'i zhvillojë apo t'i lubrifikojë marrëdhëniet midis njerëzve; pra, të promovojë rregulla të caktuara të formuluar mbi bazën e bindjes apo të thirrjes së asaj çka na përçon tradita e shëndoshë kombëtare, ose në rastet kur një traditë e tillë gjendet përballë problemeve të pazgjidhshme për të, në bazë të zërit të ndërgjegjes dhe parimit se etika favorizon parësisht lirinë.

Në një kohë kur e gjitha kjo mund të konsiderohet si një jehonë e atij libri të mrekullueshëm me titull "Etika dhe politika", që shkroi në fillim të viteve 30'të shekullit të shkuar një filozof i madh si Benedeto Kroçe. Duke kundërshtuar ndarjen ilegjitime të etikes nga politika apo moralizmin e dyshimtë si një makiavelizëm të çparagjykuar, Kroçe nuk mohonte aspak konceptin e tij, thellësisht laik dhe modern, të politikës si aktivitet të lidhur me "jetën ekonomike" të Shpirtit, ose e thënë ndryshe, me ndjekjen e qëllimeve dhe intereseve të veçanta, por përkundrazi, vinte theksin mbi raportin e ngushtë që ajo duhet të kishte me etikën, të konceptuar si frymëzimin çlirues të një tensioni që e shpëton politikën nga rreziku i shterimit në vetvete ose i mbetjes mbyllur në një sferë autonome dhe të izoluar.

Ndaj, nuk është e rastit që edhe në filozofinë e pas-luftës, pjesa më e madhe e mendimtarëve rifillojnë nga etika, e tërthorazi ose drejtpërdrejt nga Kanti. Kështu, Krüger rizbulon dimensionin origjinal të etikës te metafizika kantiane, Gadamer rikthehet te etika e finalitetit, ndërkohë që në ambientin e filozofisë politike, mjafton të përmendim dy teori mbizotëruese sot në skenarin filozofik botëror, "etikën e komunikimit" (formular nga mendimtari i madh gjerman Karl Otto Apel) dhe "etikën e diskursit", ligjëritimit (formular nga filozofi dhe sociologu më i madh modern Jürgen Habermas). Përveç kësaj, në fillim të këtij shekulli, një tjetër gjigand i sociologjisë, Max Weber, do të parashtrojë linjat e përgjithshme të etikës së tij të famshme të "bindjes", së cilës i përgjigjet në vitet '80-'90, si një kundërshti a si një alternativë, një tjetër mendimtar i madh i filozofisë moderne, Hans Jonas, me



parimet e tij të njohura të "etikës së përgjegjshmërisë".

Në fakt, koncepti i përgjegjshmërisë, e një hyrjen e vet në leksikonin e filozofisë në një periudhë relativisht të hershme, e më saktësisht në vitin 1787, kur Aleksander Hamilton, në letrat e tij të famshme federaliste, për të përshkruar raportin që duhet të ekzistojë midis qytetarëve dhe qeverisë që i përfaqëson, përdori pikërisht termin "përgjegjshmëri". Që nga ky moment, termi filloi të përdorej gjithnjë e më shpesh, qoftë në fushën juridike, në të cilën ai aludon ekzistencën e një lidhjeje të shkakut dhe pasojës mes një faktori dhe një mënyre të caktuar sjelljeje, qoftë nga pikëpamja etike, duke iu referuar atij raporti të ngushtë që lidh secilin prej nesh me pasojat e veprimeve tona. Madje, më në hollësi mund të themi se i takon pikërisht Max Weberit merita e zbulimit të ndarjes midis "etikës së bindjes" dhe "etikës së përgjegjshmërisë"; kur në rastin e parë vlen motoja kantiane "që të vihet në vend drejtësia, ia vlen të shkojë në shkatërrim edhe e gjithë bota", ndërkohë që në rastin e dytë bëhet fjalë për një "veprim racional në përputhje me qëllimin".

## Përgjegjshmëria

Në gjuhët moderne evropiane "përgjegjshmëri" do të thotë thelbësisht "të përgjigjesh". Rrjedhimisht, ajo nënkupton ekzistencën e dy kushteve: të një zëri plotësisht të përcaktuar që "thërret" dhe të një "përgjigje" ndaj tij. E më tej, kjo "përgjigje" nëpërmjet së cilës arrihet të realizohet një zgjedhje, e detyrimit të merret një vendim, duhet të mbartë mbi vete edhe vendimin e "mospërgjigjes" ndaj zërave të tjerë që e "thërresin" në mënyrë të njëkohshme. Për ta shpjeguar praktikisht, le t'i referohemi një shembulli konkret. Nëse një qeveritar e administron pronën publike duke u përkujdesur për interesat e qytetarëve të vet, atëherë ai i "përgjigjet thirrjes" që vjen prej tyre, e pikërisht falë kësaj sjelljeje nuk i "përgjigjet" thirrjes së interesave të tij personale, të lëna kështu në plan të dytë në krahasim me ato të tjerëve. Nga ky këndvështrim, çdo veprimi ynë, çdo sjellja jonë, është njëherësh një akt maksimalisht i përgjegjshëm në një drejtim dhe maksimalisht i papërgjegjshëm në një drejtim tjetër. Ndaj, mund të thuhet se nuk mund

të jesh i përgjegjshëm në mënyrë "absolutive", por vetëm në lidhje me një zë specifik në krahasim me zërat e tjerë që ngelen kësaj të padëgjuar. Ja, ky është thelbi i etikës moderne të përgjegjshmërisë.

Nëse vitet '80 mund t'i emblemizojë zhvillimi i ndjeshmërisë botërore ndaj ekologjisë dhe vitet '90 ndaj problemeve të biologjisë, mileniumi i ri duket të tregohet veçanërisht i ndjeshëm ndaj etikës në të gjitha format e saj. Sot bota perëndimore njihet bankën etike, ndërmarrjen etike, tregtinë e komunikimin etik, tatimet etike, politikën, madje dhe financat etike. Ja, kjo duhet të jetë korniza e aksionit kah të cilit duhet të drejtohem. Mirëpo, për ta përkthyer praktikisht spektrin e kësaj fjale do të na duhet në fillim të shpjegojmë ç'është etika e përse shërben ajo, për të formuluar projekte praktikë të zbatimit të saj në fushën politike e më pas ekonomike, mediatike e kështu me radhë. Përgjithësisht me etikën shoqërizohen terma të tillë si i drejtë, korrekt, i ekuilibruar, i barabartë, besnik, i ndershëm, e kështu me radhë. Ndërkohë që nga pikëpamja filozofike, ajo përcaktohet si "derivat i drejtësisë", si një busull që dëfton drejtimin korrekt që duhet të ndiqet, drejtëm ky i cili shkon përtej një respektimi të thjeshtë të ligjeve për t'u projektuar në dimensionin e një "jetese ambientale" e me lidhje të ndershme me ata që krijojnë vlera shoqërore. Nga ky aspekt, etika shfaqet si një tërësi normash të sjelljes publike dhe private, që lipset të ndiqen nga një person apo nga një komunitet personash. Ajo nuk është as e drejtë as e gabuar, por varet nga kush vlerësohet dhe se si vlerësohet. Më tej, etika është personale përpara se të jetë universale, e propozon modele sociale të pranueshëm në çdo periudhë historike të çfarëdo qytetërimi. Etika modifikohet dhe evoluon, po njëllë, edhe në varësi të dimensionit të kontekstit në të cilën ajo konsiderohet apo sipas jehonës që asaj i jepet. Ja, përse sensi që komuniteti i jep këtij termi, lipset të ndryshojë e të shndërrohet gjithnjë e më i përpiktë e më pak i papërcaktuar. Aq më tepër, që etika arrihet të transformohet në raport të ngushtë me përparimin e qytetërimin, të sistemeve shoqërore dhe të koncepteve politike që i mbështesin këto sisteme. Madje, mund të shtojmë se këto janë pikërisht edhe ato domene kryesore në të cilat duhet të fillojë puna për të vënë

në veprim lëvizjen për etikën.

## Shkenca e shpirtit

Një mjeshtër i madh i mençurisë pat thënë njëherë që në çfarëdo situatë të jetës sonë ekzistojnë gjithmonë tre energji themelore; rrjedhimisht nëse do të donim ta ndërtonim realitetin në mënyrë të ekuilibruar, harmonike dhe shpirtërore, do të na duhet t'i përdorim gjithmonë të tria bashkë këto energji themelore, që janë: Vullnet-Pushtet, Dashuri-Mençuri dhe Inteligjencë aktive ose më saktësisht tre aspektet e divinitetit të pranishme në çfarëdo feje. E nëse i instalojmë këto tre ambiente sociale brenda organizmit të shoqërisë ku po jetojmë e flasim për politikën, nuk mund të ndalemi vetëm për faktorin që ka të bëjë me pushtetin, por duhet të ndërtojmë brenda procesit politik, edhe dy faktorët e tjerë, atë të dashurisë për njerëzit dhe inteligjencën, ose e përcaktuar ndryshe Etikën dhe Ekonominë. Kjo triade, është baza e çdo shkence të komunikimit dhe e pranishme në të gjitha mësimet e mjeshtërve të mëdhenj, si Pitagora, Sokrati dhe Platoni.

Ja, përse theksohet se nëse mungon njëri prej këtyre faktorëve prodhohet ç'ekuilibër, disakord e shtrembërim i vizionit, për pasojë edhe gjykim i gabuar. Kur në fakt këto tre aspekte përfaqësojnë një unitet e njëherësh një instrument të jashtëzakonshëm për transformimin e vërtetë të mënyrës së qenies, e për rrjedhim edhe të gjithë shoqërisë. Në këtë këndvështrim, për të vlerësuar një faktor politik, duhet parasegjithash të shqyrtohet niveli i përgjithshëm evolutiv i kombit, të kuptohet se cila është e mira e tij ose hapi përpara që ai duhet të hedhë në një moment të caktuar me ponderim perspektiv, për të gjetur se në ç'mënyrë ky faktor arrihet të ndërtojë në Planin evolutiv të kombit e të ambientit që e lidh atë me gjithë njerëzimin. Ja, në bazë të kësaj sintheze duhet vendosur se cila qeveri është më e dobishme dhe ajo që i përgjigjet më shumë "gjendjes së nevojës aktuale" të kombit, për ta mbështetur pas kësaj pavarësisht simpative ose antipative tona ideologjike.

Po e gjitha kjo, nuk mund të arrihet kurrsesi nëse ndalemi vetëm në leximin e gazetave a në ndjekjen e emisioneve televizive, as duke i komentuar faktet nisur vetëm prej tyre, e as duke e lënë veten të bëhemi të sunduar në arsyen tonë të brendshme, nga faktorë thellësisht emocionalë dhe ideologjikë. Përkundrazi, duhet të zhytemi në burime të tjera, të cilat përfshihen në atë që quhet Shkenca e shpirtit, pasi është pikërisht kjo shkencë ajo që na lejon ta kuptojmë më thellë dhe më mirë planin evolutiv të një kombi, ligjet universale dhe energjitë që qeverisin ciklet e ndryshme periodike të evolucionit njerëzor. Është pikërisht kjo shkencë ajo që na bën të kuptojmë se çdo të thotë politika e parë si një polis-etikos ose e thënë ndryshe si një administrim etik i shoqërisë, apo se çfarë nënkupton t'i japësh shpirt politikës ose më detajisht atë mënyrë etike sjelljeje që sintetizon gjithçka thamë më sipër. E kjo për faktin tashmë të legjitimuar se etika është ajo pika e ekuilibrit që i lejon politikës të jetë krijuesja e harmonisë, e finalizuar në përmirësimin e raporteve njerëzore.



# NJË POET PËR POETËT

Gjermania për nder të Hafizit, ka ngritur një përmendore të madhe në rajonin e Waimar-it me emrim "Qendra ndërkombëtare e dialogut ndërmjet civilizimeve"

Sulejman MEHAZI

Hafizi lindi në shekullin e 14-të në qytetin e Shirazit (1320-1389), që ndodhet në qendër të Iranit. Që në fëmijëri për shkak ndikimit islam dhe kulturës arabe e cila ishte përhapur në atë periudhë në Iran mësoi gjuhën arabe, më pas mëson dhe Kur'anin përmendësh. Për këtë arsye e quajten Hafiz. Me rastin e datëlindjes së tij, sot e kësaj dite admiruesit e tij udhëtojnë në qytetin e Shirazit te mazoleumi që i është ngritur, me tetë kolona dhe një kupolë. Poetët nga vendet e tjera të botës vijnë e i thurin lavde poetike, Hafizit, mbi varrin e tij. Sot në shumë vende të botës organizohen përkujtime dhe simpoziume në nderim të tij.

Poezitë e Hafizit "Divani i Hafizit" ( përmbledhje poetike) karakterizohen kryesisht me ndjenja spirituale, moralit, botës së përjetimeve mistike, besimit e dashurisë ndaj Zotit. Frymëzimet poetike të Hafizit s'pajtoheshin kurrë që spiritualen, të padukshmen e vërtetë mistike - poetike ta braktiste për shkak lakmisë së kësaj bote njerëzore e të robërohej shpirti i tij artistik ndaj materiales. Për këtë shkak shumë poetë të shquar, dijetarë të mëdhenj dhe poetë idealistë pëlqejnë poezitë e Hafizit duke ftuar lexuesit që të qëndrojnë larg materies për të forcuar lidhjet me shpirtëroren dhe mistikën.

Motivet kuptimplote shpirtërore poetike drejt mistikës, së shenjtës e kanë bërë që Hafizi të përkthehet në shumë gjuhë të botës: anglisht, frëngjisht gjermanisht, arabisht, rusisht, turqisht etj. Poezitë e Hafizit ftojnë lexuesit të depërtojnë në thellësitë e shpirtit dhe mistikës për të qenë të lumtur. Mënyra e të shprehurit poetik, stili ëmbël spiritual-mistik e bëri poet të dashur në mbarë botën. Respekti ndaj fesë e besimit dhe adhurimit ndaj Zotit vërehet qartë në poezinë e tij:

*"Lufta ka pushtuar 72 kombe,  
sepse i largohen së vërtetës dhe i bashkohen mitit".*

Në këto vargje Hafizi pranon njohjen, besimin, botëkuptimin mistik e spiritual, Zotin, duke ua bërë me dije njerëzve se pa logjikuar fare e "lënë të vërtetën dhe i bashkohen mitit". Poeti i shquar gjerman Johannes Wolfgang Gëte jo vetëm që u mahnit dhe u magjeps prej përmbajtjes së lartë të poezive të Hafizit, por ishte prej atyre personaliteteve që e kuptoi shumë mirë poezinë e tij. Jo më kot Gëte thotë: "Pasi njoha poezitë e Hafizit, njoha edhe botën e madhe dhe kuptova që ekzistojnë shumë burra dhe personalitete të mëdha, me talent të fshehur, që i kanë dhënë shumë kësaj bote". Gjermania për nder të Hafizit, ka ngritur një përmendore të madhe në rajonin e Waimar-it me emrim "Qendra ndërkombëtare e dialogut ndërmjet civilizimeve".

*"Ti o saki, zbuloje të fshehtën e kupës time dhe asaj çka brenda në të,  
Dashuria në fillim ishte e lehtë, më pas lindi vështirësitë".*

Fama dhe nderi që gëzon poeti, Hafiz Shirazi, mbase në botën letrare është relative, por në Iran nuk mund të hasësh asnjë person që mos të ketë dëgjuar emrin e tij, madje çdo njeri di përmendësh të paktën disa vargje nga poezitë e tij. Në shtëpinë e çdo iraniani të arsimuar dhe kulturuar të paktën gjendet një vëllim poetik i Hafizit.

Qysh prej disa shekujsh më parë iranienët, sipas traditës të tyre, në gëzime ose hidhërime gjenin ngushëllime, por edhe kërkonin kënaqësinë e çastit te poezitë e tij, të quajtura ndryshe nga populli "Divani i dashur". Poezia e tij përcjell mesazhin e misterit, këndohet gojë më gojë dhe është e pranishme në çdo festë dhe në gëzime familjare. Këto janë mendimet e pjesës dërmuese të popujve aziatikë në lidhje me personalitetin e Hafizit. Njerëzit e kulturuar, popujt e Indisë, të Pakistanit, Afganistanit, Azisë Qendrore, Turqia, popullata e rajonit të Mesopotamisë, si dhe shtete të tjera, e njohin dhe e respektojnë shumë këtë poet të famshëm iranien.

Në Evropë para dy shekujsh njerëzit e kulturuar dhe admiruesit të poezisë dhe të letërsisë janë njohur me "Divanin e Hafizit". Fillimisht, Hafizi, u njoh nga gjermanët. Poeti i madh Gëte u magjeps nga poezitë e tij të ëmbla dhe melodioze. I impresionuar dhe i frymëzuar nga Hafizi, Gëte shkroi vëllimin me poezi "Lindja dhe Perëndimi". Skicat letrare Gëta i ka titulluar me shprehjen perse "Hafiz-Name", fjalë që shpreh admirimin e tij për Hafizin. Midis të tjerave Gëte do të shkruante: "Shpresoj të të përngjasoj ty në stilin e rimës; përsëritja e zanoreve ma mbush zemrën me kënaqësi".

Edhe poetët romantikë francezë u mrekulluan nga magjia e një poeti të tillë si Hafizi. Hygoi, në vëllimin e tij poetik "Orientalizmat", u bë rob i kësaj magjie. Po ashtu personalitete si T. Gotie, dhe Andre Zhid, e kanë vlerësuar shumë figurën e Hafiz Shirazit. Hafizi, shkruan Daniel Ladinski për B.B.C, është një nga poetët më të dashur jo vetëm në Persi, por i çmuar edhe nga shumë kultura të ndryshme- si një nga shtatë mrekullitë e botës letrare. Ja çfarë thotë kritiku letrar Ralph Waldo Emerson: "Ai nuk ka frikë asgjë, sheh shumë larg dhe i sheh të gjitha, e, kështu ai është i vetmi njeri që dua të shoh ose të jem", më tej thotë se: "Hafizi është një poet për poetët". Poezia e tij është vlerësuar edhe nga Nietzsche, edhe Garcia Lorca e vlerësonte shumë poetin sufi. Vargjet e Hafizit janë vërtetë mahnitëse dhe provokuese:

*"Unë jam një vrimë në një flautë  
nëpër të cilat kalon fryma e Krishtit,  
dëgjojeni këtë muzikë.", apo:  
"shikoni buzëqeshjen në buzët e Tokës këtë mëngjes,  
ajo u shtri sërish me mua natën e kaluar."-*

Poezia e Hafizit krijon aftësinë e të ngushëlluarit, gjallëron e pasuron ata që kanë nevojë shpirtërore. Poezia e Hafizit është dashurore që rrezaton, na lejon të ngrohemi nëse kemi të ftohtë, shuan etjen dhe urinë e brendshme shpirtërore.





# NJË POET SI GANI XHAFOLLI!



## Xhahid BUSHATI

Biografia poetike e Gani Xhafollit plotësohet në mënyrë më të plotë edhe me këtë fragment interviste që kam zgjedhur. Autori thotë: "Unë jam shkrimtar i eksperimenteve. Arti është e bukura e fjalës dhe e metaforës. Është e fshehura magjike e imagjinatës, me shumë tinguj dhe ngjyra. ... Mendoj se proza dhe poezia për fëmijë është në krizë. E pse e them këtë? Sepse gjenerata e vjetër po plaket... E një gjeneratë e re dhe avangarde mungon. Ndërsa një pjesë tjetër e gjeneratës është lodhur..."

E arti kërkon ngjyra dhe figura moderne dhe urbane. Dihet se arti plaket si pemët. Edhe përrallat duhet të vishen me kostume dhe këpucë të reja poetike. Lexuesit të vogël i duhet një imagjinatë supreme me pulla moderne. I duhet loja me figura edhe në prozë edhe në poezi. ... Letërsia për fëmijë ka vepra të mira, por janë pak. ... Dihet se shkrimtarë për fëmijë ka shumë pak. Shkrimtarët e mirëfilltë të kësaj letërsie numërohen me gishta. Kemi vepra shumë të mira, por janë pak. Specifikat e letërsisë sonë për fëmijë janë temat urbane me një strukturë dhe imagjinatë të veçantë artistike.

Unë jam shkrimtar i eksperimenteve. Jam për përmbysje... Guxoj të shkruaj edhe pa fjalë. Proza dhe poezia duhet të çlirohet prej shablloneve dhe të gjenden forma të reja të shkrimit. Jam për një poetikë të re dhe një autonomi sovranë. Arti është sintaksë kozmike, kurse krijuesi është një barometër që parandien ndërrimin e kohës. Prandaj, lirisht mund të thuhet se arti i shkruar është edhe muzikë... E deri sa është muzikë mund të bëjmë edhe ndërrime metafizike. Unë shkruaj edhe me shenja të pikësimit. Shkruaj edhe poezi sinjalistike: vizuale. Mjafton nganjëherë vetëm dy germa në një faqe. Unë flas vetëm me një mollë dhe me një kaçubë. Unë jam për një rrugë të re të një poetike jetëgjatë."

Zgjedhja e kësaj poezie dhe e këtij fragmenti të intervistës, në tërësinë e tyre na japin të qartë e në mënyrë të drejtpërdrejtë misionin fisnik të poetit dhe rrëfimin e Ganiut që (Unë Jam - ku evidentohet grafika e shkronjës së madhe), si dhe gjen mishërim palca e krijimtarisë së tij poetike. Kjo mënyrë paraqitjeje që i ngjan një parathënieje, nuk është asgjë tjetër veç autostrada e komunikimit të tij me lexuesin e vogël.

Krijimi letrar i Gani Xhafollit (poezia për të cilën po merremi e po flasim) është refleksi i të shprehurit të botës së tij të brendshme. Arrin ta dëshmojë mëvetësinë e tij përmes kundërimit të vëmendshëm të objektit: herë si akt individual, herë si akt në marrëdhënie me të tjerët. Ngjyra, loja dhe fantazia bashkërendohen në këtë akt. Është kjo arsyeja "që në poezinë e vet ka krijuar e formuar sferën poetike e tematike, veçoritë esenciale individuale që e shquajnë atë në kuadër të një kohe, të një gjenerate apo të një orientimi poetik të shkrimit". Në vazhdim të qasjes së individualitetit si proces krijues, studiuesi Prend Buzhala është i mendimit se ai (Gani Xhafolli, - nënvizimi im Xh. B.) "... riaktivizon një poetikë të tërë të një mozaiku dinamik. Është kjo, një poetikë grafemash, është semantizimi i tipave të ndryshëm të shkronjave të shtypit, janë ndërthurja e procedimorit të sekuencave tekstore dhe krijimi i lojës së fragmenteve."

Nocionet e lartpërmendura, si: poetika e grafemave, semantizimi, sekuencat tekstore, loja e fragmenteve... etj., që shfaqen si shenja e në mënyra të larmishme, kanë vendqëndrimet e njëkohësisht rrjedhat e komunikimit mes tyre në krijimet e tij poetike, të cilat janë elementë të domosdoshëm e përbërës. Ata formojnë tablo apo tabloide, të cilat studiuesi Prend Buzhala i quan me të drejtë: 'mozaiku dinamik'.

Poezia e Xhafollit e ka një mënyrë shpalosjeje të këtij 'mozaiku'.

Udhëtimi i saj paraqitet drejt këtyre modelimeve:

\*Drejt mundësisë së nisjes të krijimit.

\*Drejt një fabule të mirëfilltë.

\*Drejt një fabule në trajtë mozaiku.

\*Drejt një meditimi a përsiatjeje brenda "folesë" të lirikës së peizazhit.

Kjo mënyrë shpalosjeje bën që "Imazhet artikuloohen sipas një alfabeti që s' shkruhet, sipas një sintakse që s' dihet. Imazhet s'përkthehen. Perceptohen."

Po sjellim tre shembuj:

### Dora i duhet Diellit

Lules i mungon dora e majtë  
Një bombë e zezë ia këputi  
Nganjëherë shkon te kroji  
Mos po e gjen në pyll  
Ndonjë copë të gishtit  
Shpeshherë loton tek një kaçubë  
Kujtimet i mbulon loti.

Një ëndërr i tha një natë  
Dora jote e vogël  
Do të bëhet lule e kaltër  
I duhet diellit dhe hënës.

Nisja, që në titullin e krijimit, bëhet përmes një aliteracioni. Vargjet në vazhdim bëhen formuluese drejt një fabule të mirëfilltë. Po këtë nisje ngjashmërie ka dhe rrëfimi. Një rrëfim tregimtar, i cili bëhet në vetën e tretë, e ku autori nuk merr pjesë. Poezia ka një komunikim të drejtpërdrejtë, ku tragjikja shfaqet në plan të parë dhe bën kontrast me emrin e personazhit, që quhet Lule. Ndërsa Lulen e rrethojnë kujtimet që kanë formën e lotit, e rrethon fëmijëria që ka ngjyrën e përrallës. Në strofën e dytë autori me njeshtri i ka "ikur" fabulës e rrëfimit tregimtar, dhe preferon udhën e meditimit duke i ofruar moshës së personazhit ëndërrën (në fakt jetën), lulen e kaltër (përkon me emrin), diellin dhe hënën si figura me përmasa universale, ku i pari mbart ngrohtësi e jetë, ndërsa e dyta magji dhe bukuri hyjnore. Ngjyra përrallore, që tashmë e rrethon Lulen, vjen si qetësim dhe antipod i gjendjes dramatike, të trishtuar, tashmë të njohur në strofën e parë, aty, ku fabula sapo ka nisur të marrë jetë e që Lulja kërkon JETË.

### Lehtë mund të ngatërrohem me diell

Nëse hëna ma kërkon gjyshin  
Lehtë mund të grindem me hënën  
Nëse dielli ma kërkon gjyshen  
Lehtë mund të ngatërrohem me diellin.

Vargjet e mësipërme flasin për një tjetër shprehësi. Kësaj here përsiatja bëhet brenda "folesë" së lirikës së peizazhit. Në këtë rast loja e figurave arrin të krijojë të njëjtën tipologji artistike përrallore.

### Një dallëndyshe tjetër zbriti mbi një pikë

Një natë mbi një vjershë  
zbriti një dallëndyshe  
e nisi çerdhen me lule.

prej vargu në varg fluturoi  
hapi shumë dritare nëpër  
folje  
e thirri diellin dhe hënën

në një guaskë të argjendtë  
pi ujë

një dallëndyshe tjetër  
zbriti  
mbi një pikë  
më doli gjumi në vendlindje.

Teksti i ofruar nga poeti Gani Xhafolli na kujton ca imazhe të një natyre filmi. Një perceptim i tillë ruan "sekuenca tekstore", ku shpërfaqet loja me elementet e saj sa konkrete aq dhe abstrakte. Nuk mungon imagjinata që, në të shumtën e herës vjen nga mosha e fëmijërisë, "bisedon" me të dhe nisen drejt një udhe të pafund... për t'u kthyer përsëri në vendlindje. Gjithsesi, në këtë "bashkëbisedim" vendlindja ruan dashurinë e parë.


Ndërsa në poezinë "Hëna vizaton lule", është fëmijëria ajo, që mbart lojën dhe mallin e poetit. Grupimet e fjalëve pozicionohen në një mënyrë të tillë sa ruajnë konotacione dhe asonanca që në thelb mbartin ndërlidhje të logjikshme në mes tyre. Si për shembull: përrallat - gjyshja, pylli - zogjtë, molla - motra, etj. Poezia është ndërthurar në vetën e parë. Mënyra e të rrëfyerit është: magjike. Modelimi i ndërtimit të kujtimeve na sjell në mendje formulat hyrëse - natyrë e përrallave tona popullore. Kumti poetik i poetit është fëmijëria. Në fëmijërinë e tij është shpirti i poetit. E në shpirtin e poetit është fëmijëria e tij. Përmes magjisë së hënës, fëmijëria merr vlerat e një ikone të shenjtë, të paprekshme, të papërsëritshme e të përjetshme. Në këtë poezi, poeti kështu e percepton dhe e bën të jetojë fëmijërinë e tij.

(Shkodër, më 26.01.2023)



# DESHIFRIMI I SHENJAVE TË JETËS

Shkrimi im është një labirint pa rrugëdalje dhe aty vdes edhe vetë. Shkrimi im është gjithandej, nuk mund të reshtë. Ai është më i gjerë së fleta që e mbart, më i gjatë se gjurma e bojës së lapsit që e shkruan



## Le CLEZIO

Nuk mund të arratisesh nga jeta. Unë nuk jam i qetë, jo, nuk jam i qetë. Unë jetoj, jam në jetë, lëviz, hedh fuzhnjat dhe shigjetat e mia, gjuaj, përgjoj nga lukthi i territ. Shkrimi im është një labirint pa rrugëdalje e aty vdes edhe vetë. Shkrimi im është gjithandej, nuk mund të reshtë. Ai është më i gjerë së fleta që e mbart, më i gjatë se gjurma e bojës së lapsit që e shkruan. Unë shkruaj me të dyja këmbët e mia kur eci, me dhëmbët e mi kur ha. Unë shkruaj me të gjithë trupin tim, me shtatin e grave, me dhembjen, kënaqësinë, me frymën time. Dhe shkruhem gjatë gjithë kohës nga bota, pa mundur të them jo.. Ajri ka kaluar mbi këtë truall dhe shiu ka rrjedhur shpesh nëpër këto lugje. Ç'gjë të shkruar ka atje? Çfarë është shënuar në këtë rrasë? Emrat e të vdekurve, afërmendsh, dhe gjurmët spirale të gishtërinjve të të gjallëve. Edhe nënshkrimet. Datat e ditëve e shifrat e orëve, numrat e viteve, fazat e hënës, erërat, baticat, shpërthimet diellore. Numri i gjetheve të drurëve. Luspat e gjarpërinjve, gjymtyrët e shumëkëmbëshave. Hala peshqish, mbetje të moçme, mbeturina gostie, thërrime, sa shumë thërrime! Pikërisht kjo është prona ime, burgu im. Nuk do të dal prej këtej; por dua të numëroj kokrrizat e rërës e t'i vë secilës një emër, meqë kjo është e vetmja arsye e jetës sime. Asgjë nuk më shkatërron dot më përnjëmend. Gjithçka që ndodh, ndodh shumë larg, si në një botë tjetër. Unë jam i ulur, ndoshta përballë përjetësisë. Aksidente, pasione, dëshira, drojë, të gjitha këto janë brenda meje, lëvizin, gjallërohen, vazhdojnë të luftojnë. Brenda vetes vështroj; mbruj. Shfaqje aq e zakonshme, saqë bëhet joshpërfillëse, por krijon. Si t'i shpëtosh romanit? Si t'i shpëtosh gjuhës? Si t'i shpëtosh, qoftë edhe një herë të vetme, qoftë edhe fjalës thikë? Nuk mund të arratisesh nga jeta. Sa herë që dikush dëshiron të shkruajë, ja se çfarë duhet të bëjë: duhet të blejë një pako me letër të bardhë 21x 27 dhe një stilolaps të zi. Del nga shtëpia ndonjë ditë, aty rreth orës tre e dhjetë të pasdrekës dhe çapitet nëpër rrugë midis turmës së

zhurmshme. Zbret dy shkallë, u bie mes për mes disa kopshtjeve, ecën me kilometra përgjatë trotuaresh të përhime, ku bie pluhuri. Kapërcen më këmbë lumenjtë e makinave, duke shmangur gomat me vizatime gllabëronjëse. U hedh një vështrim semaforëve me dritë të kuqe a të gjelbër, që shkëlqejnë majë shtyllash çeliku, si dhe dritave portokalli që pulsojnë nëpër kryqëzime.

Ai ecën me këmbët e veta nëpër gjurmë të padukshme, bën përpara me trupin paksa të hepuar, me duart që i tunden në përfund krahëve. Vështron fytyrat dhe këmbët e grave, qëndron, nisat sërish, çik paksa veshje, rrëshqet përgjatë pasqyrash, shumë i zbehtë, ose më mirë kridhet në pasqyrimet e metalit të zi, yll i errët që tretet në pafundësi. Ecën përmbi hijen e vet të lehtë. Përpara një dyqani me farfuri të rëndomta e ëmbëlake, ai ndez një cigare me dy-tri fije shkrepësesh prej druri. Dielli i ka qëndruar në qafë, e djeg qetësisht dhe i nxjerr ca bulëza vocërrake djerse. Herë-herë, nga moria njerëzore në lëvizje, ia beh një fytyrë e brengosur, me sy përpirës, me flegrat dihatëse të hundës. Mandej ajo largohet, ngritur majë supeve pors emblemë. Ajri është i tejdukshëm, ajri është i rëndë, të hyn në mushkëri pors një rrënjë me brirthe të lëngët. Zhurmërimat vërshojnë, shpërthime të pakuptueshme që çajne udhët e tyre me kraterë. Rrugët zhyten thellë nëpër murana pallatesh të bardheme; në të vërtetë, ato nuk të çojnë kurrkund. Sheshet janë të pamata, më të gjera se aeroportet, më të shkreta se rrafshinat akullnajore. Aty sipër duhet ecur, kalamendur, rendur. Pikërisht këta emra duhen gërmëzuar, këto fytyra duhen njohur, këto fjalë duhen thënë. Nuk ka vend për trill, nuk ka mundësi për të vërtetë, as për gënjeshtëri. Është vetëm ky vis, gjatë gjithë kohës, nga njëri horizont në tjetrin.

\*\*\*

Loja nuk ndërpritet. Tashmë shkrimtaria po ecën, është në veprim. Ajo e ka marrë rrugën e saj përmes rrënojave të qytetërimit, po numëron të plaguarit e të vdekurit. Nëse po i largohem diçkaje,

këtë e bëj për ta njohur më mirë. Hepuar kah toka, pllakë balte me plasaritje të thara, kur dielli është pikërisht pingul. Aty-këtu, valëzime luginash e kodrinash, hone, gryka, vidhima të thepisura shkëmbore, aty më tej një pemë, një cullufe fieri, një xhufkë bari me fije të pluhurosura, një guralec i thyer me majën e ngritur përpjetë kah qielli. Ca shenja, pa dyshim, shkrime, ca kaligrame të moçme skalitur në koren e ashpër. Rrudha, kryqëzime udhësh të shënuara me shumë tëholli, edhe krisje që kanë përshkuar sipërfaqen e brishtë të qelqit. Disa vrime të thella që i ka mbushur era, me kanale që duhet të futen thellë në rropullitë e tokës, ndoshta gjer te lukthi përvëltonjë. Miniatura, fytyra vogëlane të pikturuara brenda medalionesh, trëndafil zbukurues i skalitur, pah, nyje, eshtra të thyera gishtërinjsh që mbulojnë tokën pas një shtrëngate duarsh e këmbësh, lajle-lule, vrraja vocërrake shkaktuar nga miliona vorbullime. Ajri ka kaluar mbi këtë truall dhe shiu ka rrjedhur shpesh nëpër këto lugje. Ç'gjë të shkruar ka atje? Çfarë është shënuar në këtë rrasë? Emrat e të vdekurve, afërmendsh, dhe gjurmët spirale të gishtërinjve të të gjallëve. Edhe nënshkrimet. Datat e ditëve e shifrat e orëve, numrat e viteve, fazat e hënës, erërat, baticat, shpërthimet diellore. Numri i gjetheve të drurëve. Luspat e gjarpërinjve, gjymtyrët e shumëkëmbëshave. Hala peshqish, mbetje të moçme, mbeturina gostie, thërrime, sa shumë thërrime!

\*\*\*

Pikërisht kjo është prona ime, burgu im. Nuk do të dal prej këtej; por dua të numëroj kokrrizat e rërës e t'i vë secilës një emër, meqë kjo është e vetmja arsye e jetës sime. Asgjë nuk më shkatërron dot më përnjëmend. Gjithçka që ndodh, ndodh shumë larg, si në një botë tjetër. Unë jam i ulur, ndoshta përballë përjetësisë. Aksidente, pasione, dëshira, drojë, të gjitha këto janë brenda meje, lëvizin, gjallërohen, vazhdojnë të luftojnë. Brenda vetes vështroj; mbruj. Shfaqje aq e zakonshme, saqë bëhet joshpërfillëse, por krijon. Si t'i shpëtosh romanit? Si t'i shpëtosh gjuhës? Si t'i shpëtosh, qoftë edhe një herë të vetme, qoftë edhe fjalës thikë?

\*\*\*

Në gjithë shtrirjen e rrafshët të botës është vendosur dialogu. Është një çorbë gjuhe dhe çdo fjalë është në vendin e vet, ndërsa ai zëzëllin pors mizë e palëvizur përmbi llokmën e mishit. Mijëra gojë vocërrake të sendeve e të njerëzve kumbojnë së bashku. Unë jam secila nga këto ngjarje, unë mbart brenda vetes vilen e vezëve të fjalëve që do të mposhtin. Ajo çka them, ajo çka mendoj, ajo çka jam është e shenjuar në ushtrinë e shenjave që përparojnë. Jam fluturim mizash, lakadredha e mushkonjave të acaruar. Jam barbarozë e burgosur te vazoja e kuqe, që nuk do të pëlcase kurrë. Jam lëvizja budallaqe, dridhja e mbytur, duarlëvizje e dëshirës, çast i etjes, i urisë, i pllenimit, i jashtëqitjes, i gjumit, i fjalës. Jam shpalimi, mandej tkurrja. Muskuli dhe, në krye të krahut me vena të shtendosura, është grushti që shtrëngon thikën e mprehtë. Jam ngrohtësia e diellit,

100.000 vite dritë nga njëri breg në tjetrin i Udhës së Qumështit. Shpina e gruas rioshe hepohet, ndërsa dora e saj mban penelin e hollë që shkruan në ngjyrë trëndafili te thonjtë e gishtave të këmbës. Vetëtima çan qiellin që nxihet befas, ndërsa sinjali i saj lëbyrës do të thotë diçka të tmerrshme, që nuk mund të përkthehet. Aty janë, shkruar kuturu nëpër mure, copat e letrave të shqyera, shpina e zarfave, mbulesat e tavolinave, paketat e cigareve, numërorët e telefonave, gazetatat, librat, biletat e avionit, etiketa birre.

\*\*\*

Nuk arratisem nga jeta që di të shkruaj. Muret janë ngritur, dyert e dritaret janë mbyllur. Tavani, dysHEMEJA, qilimat, mbulesat janë gatitur. Letrat janë ngjitur, xhamat përtypur, tablotë të varura. Gjithçka është aty, gati dhe asgjë nuk mungon. Qelia. Dhoma hermetike, e kotë, hapësirë e mbrame torturash, vend që nuk braktiset kurrë. Nga kupa e tavanit varet llamba e zhveshur elektrike me rreze vdekjeprurëse. Shtrati është rregulluar. Çdo gjë në vendin e vet, çdo hi në taketuken e vet. Enë, vazo të përjetshme, kuti që hapen mekanikisht, për të parë, dhe ekziston gjithmonë një kuti e re, ende, sërish. Gazeta që hapim, vazhdimisht në faqe të reja. Ka kaq shumë për të lexuar, kaq shumë fjalë të reja, histori të botës së paprerë. Askush nuk rri në paqe. Gjithçka që jeton është duke shkruar, me dorën, zërin, kthetrat, dhëmbët, me thumbat e tij plot helm të fshehur. Universi është një fletë e bardhë gjigante që të gjithë bëjnë çmos më kot për ta ndotur. Nuk ka asgjë, asnjë situatë a veprim, që të mos ketë shenjën e vet, shkronjën, kllapën katrore a pikën e zezë. Gishtërinj, janë gishtërinj mbërthyes, që kërkojnë të mbyllin përmbi prene e panjohur. Bota arratiset dhe rifillon pors uji, por çdo pikë e këtij uji është një kurth i ngrehur.

\*\*\*

Unë nuk jam i qetë, jo, nuk jam i qetë. Dhe unë ia shtoj liqenet e mia ngatërrimit të përgjithshëm, jo për të çliruar, jo për të kuptuar, por për të përpirë, edhe unë, me të gjitha thimthath e mia me thitha të hapura. Unë jetoj, jam në jetë, lëviz, hedh fuzhnjat dhe shigjetat e mia, gjuaj, përgjoj nga lukthi i territ. Shkrimi im është një labirint pa rrugëdalje dhe aty vdes edhe vetë. Shkrimi im është gjithandej, nuk mund të reshtë. Ai është më i gjerë së fleta që e mbart, më i gjatë se gjurma e bojës së lapsit që e shkruan. Unë shkruaj me të dyja këmbët e mia kur eci, me dhëmbët e mi kur ha. Unë shkruaj me të gjithë trupin tim, me shtatin e grave, me dhembjen, kënaqësinë, me frymën time. Dhe shkruhem gjatë gjithë kohës nga bota, pa mundur të them jo. Gjithsesi, sa herë që dikush do të shkruajë, ja se ç'duhet të bëjë: lipset të çapitet përmes rrugëve të qytetit, midis turmës lëvizëse, deri te shitorja e madhe plot najlon e dritë. Me të holla duhet të blejë një pako 100 fletëshe letre të bardhë shtypi 21x 27. Po i mbeti ndonjë qindarkë, duhet të shkojë pak më tej dhe, i përkulur mbi banak, të zgjedhë një stilolaps të zi, me mbishkrimin REYNOLDS, a diçka e këtitillë. Atëherë gjithçka është gati, i mbetet vetëm të rikopjojë...



NUMRI I ARDHSHEM ME 20 MARS

# HEJZA

05 MARS, 2023

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Drejtor: **Genc Halimi** (genc@takat.tv)

Rruga e Kaçanikut nr. 208, Shkup, 1000